




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave Punës dhe Transfereve  
Ministarstvo za Finansije Rad i Transfere  
Ministry of Finance Labor and Transfers*

# ► PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT PËR FËMIJË NË FORMA TË RREZIKSHME TË PUNËS





**▶ PROCEDURAT STANDARDE  
TË VEPRIMIT PËR FËMIJË  
NË FORMA TË RREZIKSHME  
TË PUNËS**



## ► FALËNDERIME

---

Ky dokument është pjesë e projektit projektit “Masat, ndërgjegjësimi dhe përfshirja e politikave në përshejtimin e veprimeve kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar (MAP 16)” në mbështetje të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) Caku 8.7. Fondet janë mundësuar nga Departamenti i Punës i SHBA-së në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me numër IL-30147-16-75-K-11. 100% e të gjitha shpenzimeve të projektit financohen nga fondet federale, në vlerë prej 22,4 million dollarësh, prej të cilave \$162,000 janë alokuar për aktivitetet në Kosovë.

## ► NJOFTIM:

---

Ky material nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet ose politikat e Departamentit të Punës të Shteteve të Bashkuara, dhe as përmendja e emrave tregtarë, produkteve komerciale ose organizatave nuk nënkupton miratimin nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara.

## ▶ TABELA E PËRMBAJTJES

---

▶ <b>HYRJE</b>	<b>8</b>
▶ <b>PËRKUFIZIMET</b>	<b>10</b>
▶ <b>PËRKUFIZIMI I PUNËS SË FËMIJËVE</b>	<b>13</b>
▶ <b>VIZIONI</b>	<b>15</b>
▶ <b>QËLLIMI I PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT</b>	<b>16</b>
▶ <b>PARIMET E PËRGJITHSHME</b>	<b>17</b>
▶ <b>KORNIZA LIGJORE</b>	<b>18</b>
KORNIZA LIGJORE KOMBËTARE	19
KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE	20
▶ <b>MEKANIZMAT INSTITUCIONAL DHE AKTERËTR TJERË TË PËRFSHIRË DREJTPËRDREJTË NË MONITORIMIN E PUNËS SË FËMIJËVE</b>	<b>21</b>
Mekanizmat institucional monitorues	21
Mekanizmat institucional operacional	21
▶ <b>PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT</b>	<b>23</b>
Masa 1: PARANDALIMI	24
Masa 2: IDENTIFIKIMI DHE REFERIMI FILLESTAR	27
Masa 3: VLERËSIMI I RASTIT (fillestar dhe gjithëpërfshirës)	32
Vlerësimi Fillestar	32
Përcaktimi i Rrezikut të Menjëhershëm	34
Vlerësimi Gjithëpërfshirës	35
Masa 4: PLANIFIKIMI I SHËRBIMEVE INDIVIDUALE	37
Marrja e pëlqimit	37
Masa 5: MBROJTJA DHE REHABILITIMI I FËMIJËVE	41
Mbrojtja e Fëmijës	41
Rehabilitimi dhe Reintegrimi i Fëmijës	41
Masa 6: ZBATIMI, SHQYRTIMI DHE MONITORIMI I RASTIT	44
Zbatimi i Planit	44
Monitorimi i planit	44
Vlerësimi i planit	45
Dokumentimi	45
Masa 7: MBYLLJA E RASTIT	46
▶ <b>MONITORIMI DHE VLERËSIMI</b>	<b>47</b>
Dokumentimi	48
▶ <b>SHTOJCAT:</b>	<b>51</b>

## ▶ LISTA E SHKURTESAVE

---

- ▶ DKA Drejtorati Komunal i Arsimit
- ▶ DKSHMS Drejtorati Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- ▶ DPSF Departamenti për Politika Sociale dhe Familje
- ▶ EDF Ekipet e të Drejtave të Fëmijëve
- ▶ FRRP Format e Rrezikshme të Punës
- ▶ IKSHPK Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
- ▶ MASHTI Ministria për Arsim, Shkencë, Teknologji dhe Inovacion
- ▶ MBPZHR Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- ▶ MR Menaxhimi i Rastit
- ▶ MSH Ministria e Shëndetësisë
- ▶ OJQ Organizata Joqeveritare
- ▶ ONP Organizata Ndërkombëtare e Punës
- ▶ PSV Procedurat Standarde të Veprimit
- ▶ QPS Qendra për Punë Sociale
- ▶ TMR Tryeza për Menaxhimin e Rastit
- ▶ UA Udhëzim Administrativ

## ► HYRJE

Në qershor të vitit 2020, në Republikën e Kosovës hyri në fuqi Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, ligj ky që në mes tjerash ka për qëllim të mbrojtë fëmijët nga të gjitha format e keqpërdorimit, shfrytëzimit apo formave tjera që vënë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës. Kapitulli i katërt në këtë ligj në mënyrë specifike adreson mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, ku ndalon punësimin e fëmijës në aktivitete që dëmtojnë sigurinë, shëndetin, moralin dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës, dhe e mandaton Inspektoratin e Punës si përgjegjës për monitorimin e punësimit të fëmijës për të garantuar mirësjelljen, sigurinë dhe kushtet e punës.

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, në vazhdim Konventa, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 1989, përfaqëson njohjen universale të të drejtave të fëmijëve. Neni. 32 I Konventës njih të drejtën e fëmijës për të qenë i/e mbrojtur nga eksploatimi ekonomik dhe punët e rrezikshme për fëmijës, si dhe të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga puna që ndërhyjnë me arsimin e fëmijës, është e dëmshme për shëndetin fizik, mendor, spirituar, moral dhe social të fëmijës. Ndaj, edhe Konventa kërkon nga shtetet që të marrin masat ligjore, administrative, sociale dhe arsimore për të mbrojtur fëmijët nga eksploatimi ekonomik dhe punët e rënda.

Të gjitha format e shfrytëzimit të fëmijëve, të cilat rrezikojnë ose shkelin integritetin fizik, mendor dhe moral të personalitetit të fëmijës, janë të rregulluara me Konventën, e cila aplikohet drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës. Për të realizuar të drejtat e fëmijës për mbrojtje nga shfrytëzimi është e nevojshme të krijohet një sistem që do të veprojë në mënyrë proaktive në drejtim të parandalimit të shfrytëzimit dhe, në të njëjtën kohë, të mundësojë një veprim të shpejtë dhe të koordinuar për të ndaluar shfrytëzimin dhe për të mbrojtur fëmijën nga rrezikimi i mëtutjeshëm, si dhe të siguroj ndërhyrjen e duhur për rimëkëmbjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sigurt të fëmijës.

Konventa e ONP-së për Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve (Neni 7) specifikon, se shtetet duhet të marrin masat e duhura për parandalimin e

angazhimit të fëmijëve në forma të rënda të punës, ofrimin e ndihmës së nevojshme dhe të duhur për largimin e fëmijëve nga format e rënda të punës, rehabilitimin dhe integrimin social të tyre, si dhe sigurimin e casjes në arsim bazik apo profesional. Organizata Ndërkombëtare të Punës (ONP) në Rekomandimin 190, duke iu referuar Nenit 6 të Konventës për Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve rekomandon që shtetet urgjentisht duhet të krijojnë mekanizma kombëtar për të monitoruar punën e fëmijëve dhe të dizajnojnë dhe të zbatojnë veprime për të eliminuar format më të rënda/këqija të punës së fëmijëve, në bashkëpunimin me institucionet qeveritare dhe joqeveritare, dhe gjithnjë duke marrë parasysh këndvështrimet e fëmijëve të prekur nga punët e rënda, familjet e tyre dhe grupet tjera të interesit. Veprimet e tilla sipas këto rekomandimi duhet të synojnë identifikimin dhe denoncimin e formave të rënda të punës së fëmijëve; parandalimin e angazhimit të fëmijëve në forma të rënda të punës; largimin e fëmijëve nga format e rënda të punës dhe ofrimin e programeve të rehabilitimit dhe integrimin social përmes masave që adresojnë nevojat e tyre fizike, psikologjike dhe arsimore. Poashtu I bëhet thirrje shteteve që ti kushtohet rëndësi e vecantë fëmijëve të vegjël, fëmijëve vajza, grupeve të fëmijëve me nevoja të vecanta, si dhe komuniteteve ku fëmijët janë më në rrezik.

**Duke pasur këto parasysh dhe bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, nevojitet me urgjencë që të bëhet monitorimi i punës së fëmijëve, që është në pajtim edhe me nenin 5 të Konventës së ONP-së nr. 182, për të shërbyer si bazë për formalizimin e procedurave standarde të veprimit për:**

- identifikimin, tërheqjen, mbështetjen dhe mbrojtjen e fëmijëve nga rruga;
- dokumentimin e trendeve të punës së fëmijëve në sektorë specifikë;
- vlerësimin e efikasitetit të ndërhyrjeve ekzistuese në nivel lokal, duke përfshirë rekomandimet dhe udhëzimet për veprime konkrete dhe hartimin e politikave, strategjive dhe planeve konkrete të veprimit dhe referimin e rasteve në Prokurori dhe Gjykata.



**► Rrjedhimisht, janë zhvilluar këto Procedura Standarde të Veprimit (PSV)**

të cilat përcaktojnë dhe qartësojnë rolet dhe procedurat e institucioneve për parandalimin, identifikimin, mbledhjen e të dhënave, referimin, trajtimin, raportimin e fëmijëve të përfshirë në forma të rrezikshme të punës; dhe synojnë të përforcojnë bashkëpunimin ndërinstytucional dhe multidisiplinar për të mbrojtur të drejtat e fëmijës dhe për të mbrojtur fëmijët nga format e rrezikshme të punës (FRRP).

Ky dokument është zhvilluar bazuar në Profilin e Monitorimit të Punës së Fëmijëve në Kosovë (2007) dhe pas hyrjes në fuqi e shfuqizon/zëvendëson atë, duke iu referuar kuadrit të ri ligjor dhe procedurave për menaxhimin e rastit të fëmijëve në punë. Poashtu, cdo ndryshim i referencave bazë mbi të cilat është ndërtuar ky dokument, reflektohet edhe në këtë dokument.

- 
- Të gjitha format e shfrytëzimit të fëmijëve, të cilat rrezikojnë ose shkelin integritetin fizik, mendor dhe moral të personalitetit të fëmijës, janë të rregulluara me Konventën, e cila aplikohet drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

## ► PËRKUFIZIMET

---

- **Fëmijë** – nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, me përjashtim të rasteve kur moshë madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet. Në rastin kur moshë e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është fëmijë, ky person konsiderohet fëmijë dhe përfiton nga ky ligj derisa moshë e tij të jetë përcaktuar plotësisht;
- **I mitur** - nënkupton fëmijën në mes të moshës katërmëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjeç;
- **Prind** - nënkupton personin/personat që e kanë lindur ose e kanë adoptuar fëmijën, të dy së bashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar, apo që kanë njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martesë;
- **Përgjegjësi prindërore** – nënkupton obligimin e prindit për sigurimin e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim sigurimin e mirëqenies emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur dhe mbajtur raporte vetanake me fëmijën dhe obligimin për t'i siguruar fëmijës mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë së fëmijës;
- **Mbrojtja e fëmijës** - nënkupton parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe punës së fëmijës në dhe jashtë shtëpisë;
- **Fëmijë në nevojë për mbrojtje** - është personi nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individi nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer vepër penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin;
- **Puna e lejuar për fëmijë** - është pjesëmarrja e fëmijës në aktivitete ekonomike që nuk janë të dëmshme për zhvillimin dhe shëndetin e fëmijës, posaçërisht nuk i pengojnë që të vijojnë shkollimin dhe shfrytëzimin e kohës së lirë. E lejuar është edhe puna e cila është pjesë e praktikës profesionale dhe nën mbikëqyrjen përkatëse, pasi të jenë evidentuar dhe eliminuar të gjitha rreziqet;
- **Puna e ndaluar për fëmijë** - është puna apo aktiviteti i cili dëmton sigurinë, shëndetin, moralin dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës, si rezultat i mungesës së përvojës dhe njohurive për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës;
- **Format e rrezikshme të punës së fëmijës** - janë punë që mund të rezultojnë me vdekje, lëndime (shpeshherë permanente) apo sëmundje (shpeshherë permanente) të fëmijës, si pasojë e mospërshtatjes së natyrës së punës me moshën dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës dhe sigurisë së pamjaftueshme në vendin e punës;
- **Përfaqësues ligjor**- nënkupton prindin apo kujdestarin i cili, brenda përgjegjësisë që i janë dhënë nga legjislacioni në fuqi ose nga gjykata, mbron interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës;
- **Dhunë ndaj fëmijës** – nënkupton çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual;
- **Neglizhimi i fëmijës** - nënkupton mosveprimin me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës;
- **Parandalimi** - nënkupton një sërë masash të përbashkëta të ndërhyrjes së hershme edukative, arsimore, sociale dhe ligjore në favor të fëmijës dhe familjes, që është i

kërcënuar apo në rrezik në zhvillimin e tij, në mënyrë për t'i rivendosur kushtet për zhvillimin e tij, për t'i parandaluar aktet e keqtrajtimit apo për të parandaluar përsëritjen e tyre duke mundësuar rivendosjen e kompetencave prindërore-rehabilitimin e kompetencave prindërore;

- **Mbrojtja e fëmijës** - nënkupton aktivitetet që ndërmerren për t'i mbrojtur fëmijët që janë duke vuajtur, ose ka të ngjarë të vuajnë nga një rrezik serioz, si dhe çdo veprim që siguron fëmijën të jetojë në një familje apo mjedis tjetër të sigurt, ku mbrohet jeta dhe shëndeti dhe respektohen të drejtat e tij, ku sigurohet edukimi, arsimit dhe zhvillimi, duke i mbrojtur ata nga çfarëdo lloj dhune, shfrytëzimi, ndëshkimi trupor, keqtrajtimi, eksploatimi, lënie pas dore, abuzimi dhe shfrytëzimi, në çdo kontekst, përfshirë, por duke mos u kufizuar në rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin, punën e fëmijës dhe praktikën e dëmshme tradicionale, si gjymtimi i organeve gjenerale, martesë e fëmijës dhe abuzimi;
- **Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve** - nënkupton çdo shërbim për ofrimin e kujdesit social ose psikosocial, ndihmës juridike, përfaqësimit ligjor, kujdesit shëndetësor, ndihmës ar- 11 simore dhe kulturore ose, në rrethana të jashtëzakonshme, ndihmës materiale për fëmijën në nevojë;
- **Tryeza Multidisiplinare për Ndihmë në Menaxhimin e Rastit** - nënkupton grupin multidisiplinar, që përfshinë profesionistët nga institucionet përkatëse për mbrojtjen e fëmijës dhe akterët e tjerë që përfaqësojnë një shumëllojshmëri të disiplinave, të cilët kanë përgjegjësi për mbrojtjen e fëmijës, ndërveprojnë dhe koordinojnë përpjekjet e tyre për të trajtuar rastet specifike të abuzimit, keqtrajtimit të fëmijës dhe lënien pas dore të tyre në bazë të interesit më të mirë të fëmijës. Fëmija dhe familja mund të jenë pjesëmarrës në tryeza;
- **Menaxher i rastit** - nënkupton zyrtarin përgjegjës i caktuar nga Organi i Kujdestarisë për menaxhimin e rastit të fëmijës, i cili, në bashkëpunim me akterët relevantë, vlerëson nevojat e fëmijës dhe harton planin e përkujdesjes;
- **Qendra për Punë Sociale (QPS)** - nënkupton institucionin publik profesional, të nivelit komunal, kompetent edhe për mbrojtjen e fëmijës në nevojë;
- **Institucion** - nënkupton të gjitha institucionet publike, të nivelit qendror dhe lokal, si dhe personat e tjerë juridikë e privat në Republikën e Kosovës, që kanë përgjegjësinë për mbrojtjen e fëmijës në këtë Ligj dhe legjislacionin në fuqi;
- **Sistemi për mbrojtjen e fëmijës** - nënkupton strukturën e caktuar formale dhe jo formale, me funksionet dhe kapacitetet e përmbledhura dhe të bashkuara për të parandaluar dhe reaguar dhunën, abuzimin, neglizhimin dhe shfrytëzimin e fëmijës. Sipas kuptimit të përgjithshëm, sistemi për mbrojtjen e fëmijës përbëhet nga këto komponente: resurset njerëzore dhe financiare, ligjet dhe politikën, qeverisja, monitorimi dhe mbledhja e të dhënave, shërbimet mbrojtëse dhe reaguese, si dhe menaxhimi i rastit. Sistemi përfshin edhe akterë të ndryshëm, siç janë: fëmijët, familja, komuniteti, shërbyesit dhe zyrtarët e nivelit qendror dhe lokal, duke mos përjashtuar edhe ata në nivel ndërkombëtar. Funksionimi i sistemit varet nga ndërveprimi dhe marrëdhëniet ndërmjet komponentëve dhe akterëve brenda këtij sistemi.
- **Fëmijë me aftësi të kufizuara** - nënkupton fëmijët, të cilët kanë një e më shumë aftësi të kufizuara, si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor, intelektual dhe psiko/motor, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje të përkohshme apo të përhershme, të cilët e vështirësojnë mbarëvajtjen e jetës së përditshme.
- **Interesi më i mirë i fëmijës** - në të gjitha veprimet dhe vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo nga organet legjislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese dhe më e larta. Kjo kërkon një përpjekje tërësore për të siguruar integritetin fizik, psikologjik, moral dhe shpirtëror të fëmijës dhe për të

promovuar dinjitetin njerëzor, duke marrë parasysh karakteristikat individuale dhe gjendjen sociale të fëmijës. Interpretimi i interesit më të mirë të fëmijës duhet të jetë në tërësi në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, si dhe asnjë interpretim i supozuar i asaj se çka është në interesin më të mirë të fëmijës nuk mund të justifikojë shkeljen e çfarëdo të drejte të njohur nga Konventa;

- **Menaxhim i rastit**- është një mënyrë e organizimit dhe kryerjes së punës për t'i adresuar nevojat individuale të fëmijës (dhe familjes së tij) në mënyrë të përshtatshme, sistematike dhe me kohë, nëpërmjet mbështetjes dhe/ose referimeve të drejtpërdrejta (Global Protection Cluster, 2014);
- **Referim i rastit**- është procesi i të kërkuarit në mënyrë zyrtare të shërbimeve për një fëmijë ose familjen e tij nga një agjenci tjetër përmes një procedure të përcaktuar;

---

►► Shprehjet tjera të përdorura në këtë dokument kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës.

## ► PËRKUFIZIMI I PUNËS SË FËMIJËVE

Jo të gjitha punët që kryejnë fëmijët dhe adoleshentët duhet të klasifikohen si “punë e fëmijëve”. Kjo varet nga mosha e fëmijës, lloji i punës, orari i punës, kushtet nën të cilat bëhet puna dhe rrezikshmëria për fëmijën. Punët të cilat nuk ndikojnë negativisht në shëndetin dhe zhvillimin personal të fëmijëve, që nuk ndërhyjnë në shkollimin e tyre dhe jetën e tyre fëmijërore sociale, dhe që nuk paraqesin rrezikshmëri për aftësitë psikofizike të fëmijës, konsiderohen që janë përvoja pozitive të angazhimit të fëmijës që kontribuojnë në zhvillimin e fëmijëve dhe në mirëqenien e familjeve të tyre dhe gjithashtu u sigurojnë atyre aftësi dhe përvojë, si dhe i ndihmojnë në përgatitjen e tyre për të qenë anëtarë produktivë të shoqërisë gjatë jetës së tyre si të rritur.

Kështu, puna e lejuar për fëmijët mbi moshën minimale për llojin e punës në fjalë konsiderohet si pjesëmarrje në aktivitete ekonomike jo të dëmshme për zhvillimin dhe shëndetin e fëmijës, dhe veçanërisht që nuk e pengon atë të ndjekë shkollimin dhe të luaj.

Termi **“punë e fëmijëve”** shpeshherë përkufizohet si punë që privon fëmijërinë e fëmijës, potencialin dhe dinjitetin e tij dhe që është e dëmshme për zhvillimin fizik dhe mendor. I referohet punës që:

- mendërisht, psikologjikisht, shoqërisht dhe moralisht është e dëmshme dhe e rrezikshme për fëmijët; dhe
- ndërhyr në shkollimin e fëmijëve duke: (a) i privuar ata nga mundësia për të ndjekur shkollën, (b) i detyruar ata të lënë shkollën para kohe, ose (c) i detyruar ata të ndjekin shkollën në kushte shumë të vështira

Puna e fëmijëve ndikon në zhvillimin e fëmijëve sa i përket shëndetit, arsimit, moralit dhe mirëqenies psikologjike. Ajo gjithashtu prek familjen dhe shoqërinë. Ndikimi tek fëmija mund të shtrihet nga lëndimet e gjymtimet fizike, helmimet, problemet shëndetësore e deri të ndikimi negativ në zhvillimin mendor, moral e shoqëror të fëmijës dhe mbi të gjitha keqtrajtimi i fëmijës. Ndikimi në familje, mes tjerash, përjetëson varfërinë familjare përmes kapitalit më të ulët njerëzor, pasi puna e fëmijëve

nuk çon në zhvillimin e aftësive. Në anën tjetër, puna e fëmijëve mund të ngadalësojë rritjen dhe zhvillimin shoqëror përmes zvogëlimit të akumulimit të kapitalit njerëzor. Nëse fëmijët në fakt zëvendësojnë punëtorët e rritur duke krijuar papunësi të të rriturit dhe/ose ulje të pagave të të rriturve mbetet një pyetje e hapur; por në atë masë që fëmijët konkurrojnë me të rritur të pakualifikuar për punë të njëjta, fëmijët në punë ndikojnë në punësimin e të rriturve ose në pagat e të rriturve në varësi të strukturës së tregut të punës

Përderisa puna e fëmijëve merr shumë forma të ndryshme, prioritet është të eliminohen pa vonesë format më të këqija të punës së fëmijëve, siç përcaktohet në nenin 3 të Konventës së ONP-së për format më të këqija të punës së fëmijëve nr. 182 (1999). Format më të këqija të punës së fëmijëve përfshijnë:

- a. të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me skllavërinë, të tilla si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, detyrimi skllavëruar dhe bujkrobëria dhe puna pa dëshirë ose e detyruar, përfshirë rekrutimi pa dëshirë ose të detyruar për përdorim në konflikte të armatosura;
- b. përdorimin, kërkimin ose dhënien e një fëmije për prostitucion, për prodhim pornografie ose për shfaqje pornografike;
- c. përdorimin, kërkimin ose dhënien e një fëmije për veprimtari të paligjshme, në veçanti për prodhimin dhe trafikimin e drogave narkotike sikundër janë përkufizuar në traktatet përkatëse ndërkombëtare;
- d. punët të cilat, nga natyra ose rrethanat në të cilat kryhen mund të rrezikojnë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve.

Sa i përket punës së rrezikshme për fëmijët, versioni i parë i listës së punëve të rrezikshme për fëmijë në Kosovë është përgatitur me mbështetjen e ONP-së gjatë periudhës 2005-2007, dhe ka hyrë në fuqi ligjërisht si Udhëzim Administrativ i Qeverisë për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rrezikshme për Fëmijë në Kosovë (UA 17/2008). Udhëzimi Administrativ rendit (a) sektorët e rrezikshëm dhe (b) aktivitetet e përgjithshme të rrezikshme që duhet të ndalohen si çështje parësore. Në vitin 2013, UA 17/2008 u zëvendësua me UA 05/2013, duke përditësuar listën e punëve të rrezikshme për fëmijë në Kosovë. Sic është cekur edhe në hyrjen e këtij dokumenti, cdo ndryshim/përditësim i referencave bazë mbi të cilat është ndërtuar ky dokument, reflektohet edhe në këtë dokument.

#### **Aktivitetet e përgjithshme të rrezikshme përfshijnë:**

- punën gjatë natës (ndërmjet orës 20:00 dhe 6:00);
- ngritjen dhe bartjen e kohëpaskohshme të peshave të rënda mbi 15 kg (M) dhe 10 kg (F);
- ngritjen dhe bartjen e vazhdueshme të peshave mbi 10 kg (M) dhe 5 kg (F);
- punën në thellësi, në sipërfaqe të tokës, nën ujë dhe vende të mbyllura;
- punën në lartësi mbi 2 m;
- punën që mund të shkaktojë dëme në shëndetin e fëmijës për shkak të ekspozimit ndaj temperaturave ekstreme të larta apo të ulëta, ose ndaj zhurmës dhe dridhjes;
- ekspozimin ndaj substancave biologjike, kimike dhe toksike, dhe ekspozimin ndaj radioaktivitetit.

**Sektorët dhe aktivitetet specifike të rrezikshme përfshijnë: sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë, punën në rrugë, punën në ndërtimtari, punën në deponi të mbeturinave dhe punën në eksploatimin e pasurive natyrore.**

---

## ► VIZIONI

---

Vizioni i Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) është që nëpërmjet zbatimit të këtij dokumenti institucionet e Republikës së Kosovës të sigurojnë mbrojtje më të mirë të fëmijëve dhe adoleshentëve. Vizioni i këtij dokumenti është që këto procedura të përmirësojnë reagimin e shtetit ndaj rasteve të punës së rëndë të fëmijëve; viktimat të mbrohen nga viktimizimi sekondar dhe të inkurajohen, të sigurohen e të fuqizohen për t'u mbrojtur nga punët e dëmshme dhe abuzive si dhe të ri-integrohen në një shoqëri të shëndoshë.

## ► QËLLIMI I PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT

Qëllimi i PSV është krijimi i një sistemi proaktiv, referues, reagues, dhe të koordinuar të institucioneve të Kosovës, të cilat duhet të reagojnë në formë të menjëhershme dhe të vazhdueshme në rastet e punës së rëndë të fëmijëve me qëllim të parandalimit, referimit, ofrimit të ndihmës cilësore, shërbimeve të integruara dhe mbrojtjes së fëmijës. Dokumenti ka për qëllim të qartësojë rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve kompetente në mbrojtjen e fëmijëve përmes identifikimit, referimit, mbrojtjes dhe rehabilitimit si dhe reintegrimit. Me masa aktive dhe reaktive ligjore mbrohet fëmija/adoleshenti dhe ndëshkohet shfrytëzuesi.

Me hartimin dhe zbatimin e këtyre procedurave standarde të veprimit, mekanizmat institucional shtetëror dhe partnerët tjerë, do të harmonizojnë dhe koordinojnë bashkëpunimin dhe bashkërendimin, në fazat e aktiviteteve të parandalimit, identifikimit, referimit, mbrojtjes, rehabilitimit dhe riintegritimit të fëmijëve dhe adoleshentëve nga puna e fëmijëve. Këto procedura janë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, standardeve ndërkombëtare dhe politikave institucionale.

Për më tepër ky dokument ofron bazë edhe për vendim-marrje të informuar (të bazuar në fakte) për adresimin e mangësive të sistemit dhe sfidave me të cilat përballen institucionet në përmbushjen e funksionit të tyre.

### PSV-te në mënyrë të veçantë synojnë:

- Identifikimin, referimin, tërheqjen, përkrahjen dhe mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës,
- Dokumentimin e vazhdueshëm të trendeve dhe shtrirjes së punës së fëmijëve sipas lokacioneve gjeografike dhe sektorëve dhe
- Vlerësimin e vazhdueshëm të efektivitetit të masave ekzistuese në nivelin qendror dhe në ate lokal, përfshirë edhe rekomandimet dhe udhëzimet për veprime konkrete dhe zhvillim/avansim të vazhdueshëm të politikave në nivele të ndryshme të qeverisjes.

### Realizimi i qëllimeve të PSV arrihet përmes:

- Përbushjes së obligimeve të akterëve përgjegjës për monitorimin e punës së fëmijëve
- Ndërmarrjes së masave ligjore në zbatimin e procedurave të identifikimit, referimit, mbrojtjes, rehabilitimit dhe reintegrimit
- Bashkërendimit të aktiviteteve ndërmjet akterëve institucional për reagimin ndaj rasteve të punës së fëmijëve përmes ofrimit të shërbimeve të integruara
- Zbatimin e masave të nevojshme të trajtimit në institucionet gjegjëse si dhe masave të rehabilitimit dhe reintegrimit të fëmijëve.
- Monitorimin, raportimin, vlerësimin dhe zbatimin e mbrojtjes nga punët e rënda nga akterët përgjegjës.

**Procedurat Standarde të Veprimit për monitorimin e punës së fëmijëve, në vijim PSV, hartohen në zbatim të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve 06/L-084. Ato synojnë mbrojtjen, përfshirë identifikimin në kohën dhe mënyrën e duhur të fëmijëve, kosovarë apo të huaj apo persona pa shtetësi, për të gjitha llojet e punës dhe shfrytëzimit, të lidhur apo jo me krimin e organizuar.**



## ► PARIMET E PËRGGJITHSHME

---

- **Qasja e Procedurave Standarde të Veprimit** është e bazuar në të drejtat e njeriut dhe është një qasje sensitive për mbrojtjen e fëmijëve, duke synuar interesin më të lartë të tyre. PSV-të marrin në konsideratë në mënyrë specifike detyrimin e posaçëm që ka shteti në lidhje me fëmijët, më konkretisht mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në përputhje me Ligjin nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës bazuar në interesin më të lartë të tij/saj.
- **Mbijetesa dhe zhvillimi** - e drejta e fëmijës në zhvillimin fizik, mendor, emocional, edukativ, shëndetësor, social si dhe mirëqenia e fëmijës, duhet të jenë të mbrojtura në masën maksimale të mundshme nga çdo person, institucion apo organ tjetër.
- **Mosdiskriminimi** - mbrojtja e fëmijës pavarësisht nga statusi i familjes, origjinës etnike dhe karakteristikave të tjera sociale ose individuale të fëmijës (racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, kombësisë, karakteristikave psikike dhe fizike ose specifikave të tjera të fëmijës dhe familjes së tij/saj).
- **Interesi më i mirë i fëmijës** - garanton që interesat më të mira të fëmijës marrin përparësi ndaj interesave të prindit, ose kujdestarit, institucionit ose komunitetit, në situata kur këto interesa ndryshojnë nga interesat e fëmijës.
- **Pjesëmarrja e fëmijëve** - sigurohet duke i mundësuar fëmijëve të marrin informacion të duhur dhe për të shprehur dëshirat, pikëpamjet dhe mendimet e tyre për të gjitha çështjet që i shqetësojnë ata dhe në të gjitha fazat e procesit të mbrojtjes në një mënyrë që i përshtatet moshës së tyre dhe të kuptuarit e situatës.
- **Mbrojtja e të drejtës për privatësi** – fëmijës i garantohet e drejta për privatësi, respektimi i jetës private dhe familjare, mbrojtja e të dhënave personale dhe duhet të mbrohet nga ndërhyrjet keqdashëse, arbitrare, dhe të kundërligjshme që prekin moralin, dhe dinjitetin e fëmijës.
- **Mbrojtja nga dëmtimi i mëtejshëm** - veprimet dhe intervenimet që kanë për qëllim t'i mbështesin fëmijët (dhe familjet e tyre apo kujdestarët ligjor), nuk duhet t'i ekspozojnë ata para një dëmi tjetër. Duhet pasur kujdes që të sigurohet se asnjë masë nuk do të çenojë të drejtat dhe dinjitetin e fëmijëve, asnjë dëm nuk u shkaktohet fëmijëve apo familjeve të tyre si rezultat i sjelljes së personave zyrtar, të vendimeve të marra apo të veprimeve të ndërmarra. Duhet pasur po ashtu kujdes që të sigurohet se asnjë dëm nuk u shkaktohet fëmijëve apo familjeve si rezultat i mbledhjes, ruajtjes apo ndarjes së informatave të tyre.
- **Pjesëmarrja e organizatave** shërbim ofruese për fëmijët dhe e organizatave të shoqërisë civile është e domosdoshme për arritjen e synimeve të PSV-vë, d.m.th. mbrojtjen, parandalimin dhe ndihmën ndaj fëmijëve në punë të rënda. Të gjithë akterët shtetërorë dhe joshtetërorë, përfshirë shoqërinë civile, marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e veprimtarisë së monitorimit të punës së fëmijëve. Organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol kyç, dhe si të tilla, mendimet dhe pikëpamjet e tyre janë të pasqyruara mirë në hartimin dhe zbatimin e këtyre Procedurave Standarde të Veprimit.

## ► KORNIZA LIGJORE

---

Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijës përfshin kornizën ligjore, strukturat, masat dhe veprimet të cilat koordinojnë ndërhyrjet për të parandaluar, identifikuar në kohë, vlerësuar dhe ndërhyrë përmes një plani veprimi multidisiplinar dhe që synon mbrojtjen e fëmijës, si dhe mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës (Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës). Një njohuri e plotë e ligjeve dhe detyrimeve që u përcaktojnë institucioneve publike, duke përfshirë administrimin e shërbimeve dhe kompetencën ligjore të atyre institucioneve në adresimin e punës së fëmijëve është thelbësore, nëse Qendrat për Punë Sociale (QPS) dhe Zyrtarët e Shërbimeve Sociale janë për të mbështetur interesat e fëmijëve në punë. Korniza ligjore që rregullon mbrojtjen e fëmijëve nga puna e fëmijëve është paraqitur më poshtë.

## ► KORNIZA LIGJORE KOMBËTARE

---

- Ligji nr. 06/L084 për Mbrojtjen e Fëmijës
- Ligji nr. 2004/32 Ligji për familjen i Kosovës dhe Ligji nr. 06/L-077 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës
- Ligji nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe Ligji nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare
- Draft Ligji I ri për Shërbimet Sociale dhe Familjare (momentalisht ne diskutim publik- 2021)
- Ligji nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë dhe Ligji nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale
- Ligji nr. 04/L -032 për Arsimin Parauniversitar
- Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komuna
- Ligji nr. 03/L -212 i Punës
- Ligji nr. 04 / L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë
- Kodi nr. 06/L-074 Kodi Penal
- Kodi nr. 06/L -006 Kodi i Drejtësisë për të Mitur
- Ligji nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit
- Projekt- Udhëzim Administrativ për Ekipin për të drejtat e fëmijës (draft verzion)
- Projekt- Udhëzim Administrativ për identifikimin, raportimin, referimin ndaj shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit të fëmijëve
- Projekt- Udhëzim Administrativ për Autoritetet për të drejtat e fëmijës
- Projekt- Udhëzim Administrativ për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë
- Projekt- UA për tryezat multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve
- Udhëzimi Administrativ 08/2018 për themelimin e fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në shkollë
- Udhëzues për menaxhimin e rastit të fëmijëve në punë

## ▶ KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE

---

- ▶ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
- ▶ Karta e të drejtave Fundamentale të Bashkimit Evropian
- ▶ Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
- ▶ Konventa e ONP-së 182/2000 ndalimi dhe veprimi i menjëhershëm për eliminimin e formave të rënda të punës së fëmijëve.
- ▶ Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe lirive themelore.
- ▶ Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin e torturës, të trajtimeve e ndëshkimeve çnjerëzore dhe poshtruese.

Aspektet specifike të rregulluara në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga puna janë të paraqitura detajisht në Udhëzuesin për menaxhimin e rastit të fëmijëve në punë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Social (Prishtinë, 2020)

## ► MEKANIZMAT INSTITUCIONAL DHE AKTERET TJERË TË PËRFSHIRË DREJTPËRDREJTË NË MONITORIMIN E PUNËS SË FËMIJËVE

---

### Mekanizmat institucional monitorues

1. Gjykatat
2. Ministria përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale
3. Ministria përkatëse e Punës
4. Departamenti për Politika Sociale dhe Familje
5. Ministria përkatëse e Arsimit dhe Shkencës
6. Ministria përkatëse e Shëndetësisë
7. Ministria përkatëse e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
8. Ministria përkatëse e Administrimit të Pushtetit Lokal
9. Komuna
10. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
11. Drejtoria Komunale për Arsim
12. Drejtoria Komunale e Bujqësisë
13. Zyra e Avokatit të Popullit
14. Inspektorati i Policisë
15. Prokurori i Shtetit
16. Koalicioni i OJQ-ve për Mbrotjen e Fëmijëve

### Mekanizmat institucional operacional



17. Inspektorati i Punës
18. Policia e Kosovës
19. Inspektorati Komunal
20. Qendrat për Punës Sociale
21. Qendrat e Mjekësisë Familjare
22. Institucionet e kujdesit dytësor dhe tretësor shëndetësor
23. Qendrat e Shëndetit mendor
24. Shkollat
25. Agjencia për zhvillim rural
26. Agjencia e Pyjeve
27. Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
28. Zyrat e Punësimit
29. Qendrat e Aftësisë Profesionale
30. Tryezat për Menaxhimin e Rasteve
31. OJQ-të dhe Strehimoret

Përgjegjësitë ligjore të agjencive të zbatimit të ligjit, dhe ofruesve të shërbimeve publike dhe joqeveritare të listuar lartë janë detajuara në ligjet përkatëse dhe janë të paraqitura detajisht edhe në Udhëzuesin për menaxhimin e rastit të fëmijëve në punë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Social (Prishtinë, 2020).



# PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT

---



## Masa 1: PARANDALIMI

Parandalimi është masa e parë në PSV. Ajo përfshin veprimtaritë që ndërlidhen me informimin, vetëdijësimin dhe parandalimin e dukurisë së punës së fëmijëve. Për parandalim të suksesshëm të punës së fëmijëve, fillimisht duhet të krijohet një mjedis i favorshëm për parandalimin. Kjo nënkupton fillimisht përmirësimin e bazës së njohurive për punën e fëmijëve që është thelbësore për të gjitha aktivitetet për parandalimin e punës së fëmijëve, dhe ndërgjegjësimin e popullatës së përgjithshme dhe grupeve të vecanta të popullatës për pasojat negative të punës së fëmijëve dhe pasojat ligjore të shfrytëzimit të fëmijëve për punë të rrezikshme.

## Masat

### 1. MONITORIMI I SITUATËS SË FËMIJËVE NË PUNË ME QËLLIM IDENTIFIKIMIN E MANGËSIVE NË SISTEMIN E MBROJTJES SË FËMIJËVE DHE PLANIFIKIMIN E MASAVE PËR ADRESIMIN E TYRE

Veprimet	Dokumentimi	Përgjegjës	Veprime mbështetëse nga akterët tjerë
Vlerësimi vjetor në nivel vendi i situatës së përgjithshme të mbrojtjes së fëmijëve në punë	Raporti i vlerësimit	DPSF	Komunat QPS-të
Takime vjetore me fokus analizën vendore të shkaqeve bazuar në të dhënat e përfituara nga rastet konkrete të punës së fëmijëve	Raportet e takimeve, rekomandimet e nxjerra dhe vendimet për adresimin e sfidave/planet e veprimit në nivel vendi	Departamenti i Politikave Sociale  Mekanizmat ndër-institucional në nivel qendror	MASHTI MSH Drejtoritë Komunale QPS Mekanizmat operacional
Vlerësimi vjetor në nivel komunal i situatës së përgjithshme të mbrojtjes së fëmijëve në punë	Raporti i vlerësimit	Komunat	QPS Shkollat OJQ-të
Takime periodike në nivel komune për analizën e shkaqeve bazuar në të dhënat e përfituara nga rastet konkrete të punës së fëmijëve në komunën përkatëse	Raportet e takimeve, rekomandimet dhe vendimet për adresimin e sfidave/planet e veprimit në nivel të komunave	Komunat	Mekanizmat operacional



**2. INFORMIMI DHE VETËDIJËSIMI I POPULLATËS SË PËRGJITHSHME DHE GRUPEVE TË VECANTA TË POPULLATËS PËR PASOJAT NEGATIVE TË PUNËS SË FËMIJËVE DHE PASOJAT LIGJORE TË SHFRYTËZIMIT TË FËMIJËVE PËR PUNË TË KËQIJA.**

Veprimet	Dokumentimi	Përgjegjës	Veprime mbështetëse nga akterët tjerë
Informimi dhe vetëdijësimi i fëmijëve dhe shkollave gjatë vizitave sistematike në shkolla	Raportet e vizitave sistematike	QMF IKSHPK	Shkollat
Takime me prindërit në shkolla dhe në komunitete për informim rreth punës së fëmijëve	Raportet e takimeve	Shkollat	QPS-të OJQ-të
Informimi dhe vetëdijësimi i familjeve gjatë vizitave familjare dhe takimeve për skemat e ndihmës sociale dhe shërbimet sociale	Raportet e vizitave	QPS-të	OJQ-të
Vetëdijësimi i punëdhënësve për pasojat e angazhimit të fëmijëve në punë të rrezikshme	Evidenca nga aktivitetet vetdijësuese	Inspektorati i Punës	Organizatat e Punëdhënësve Sindikatat
Vetëdijësimi i fermerëve mbi format e rrezikshme të punës në bujqësi, efektin negativ në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve dhe masat për parandalimin/ tërheqjen e fëmijëve nga ky angazhim;	Evidenca nga aktivitetet vetdijësuese	MBPZHR Agjencia e Zhvillimit Rural Drejtoria Komonale të Bujqësisë	Shkollat QPS-të Shoqatat e fermerëve
Vetëdijësimi i familjeve për rreziqet dhe pasojat e angazhimit të fëmijëve në aktivitete të rrezikshme bujqësore	Evidenca të këshillimeve	Drejtoria Komonale të Bujqësisë	Shoqatat e fermerëve Shkollat
Fushata vjetore vetëdijësuese për popullatën e përgjithshme	Broshura Fletëpalosje Posterë Emisione mediatike	DPSF Komunat OJQ-të	Mekanizmat monitorues dhe operacional

## Masat tjera parandaluese përfshijnë:

- Vendosjen e bashkëpunimit ndërinstitucional për koordinimin e punës, shkëmbimin e informatave përkatëse;
- Informimin dhe sensibilizimin e fëmijëve të përfshirë në FRRP, familjarëve të tyre dhe publikut të gjerë për efektet e dëmshme të FRRP së fëmijëve;
- Bashkëpunimi i ngushtë me institucionet qeveritare dhe joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare që zhvillojnë programe në parandalimin dhe eliminimin e FRRP të fëmijëve
- Trajnime të vazhdueshme nëpër regjione me të gjitha institucionet përgjegjëse për parandalim të punës së fëmijëve në përputhje me mandatin e tyre ligjor
- Intervenimi në kurikulat shkollore rreth vetëdijësimit të fëmijëve për të drejtat e tyre për rreziqet nga aktivitete të ndryshme punuese dhe detyrimin e prindit apo kujdestarit dhe shtetit për të siguruar mirëqenien dhe mirërritjen e fëmijës, edukimin dhe shkollimin, si dhe mbajtjen me plotësimin e të gjitha kushteve për jetë normale.
- Sensibilizimi i të gjithëve për detyrimin ligjor dhe qytetarë për lajmërimin e punëve të rënda të fëmijëve
- Vetëdijësimi i institucioneve shkollore, shëndetësore, inspektorateve, si dhe institucioneve tjera që kanë kontakt me fëmijët që të referojnë rastet në momentin që mësojnë se një fëmijë është abuzuar në të gjitha format, përfshirë edhe format e rënda të punës së fëmijëve, si dhe sensibilizimi i tyre se mos lajmërimi i veprave të tilla penale gjatë kryerjes së detyrës të tyre zyrtare dhe mos referimi në organet kompetente të hetuesisë përbën vepër penale për ta.
- Organizimi i fushatave sensibilizuese dhe vetëdijësuese për format e rrezikshme të punës së fëmijëve në bujqësi, përfshirë pylltarinë, si dhe këshillime për mënyrat e mbrojtjes së fëmijëve: (a) përmes takimeve individuale e grupore me fëmijë, prindër, mësimdhënë, fermer, punëdhënë/operator; (b) përmes mediave, materialeve informative, takimeve të drejtpërdrejta informuese dhe këshilluese; Pjesëmarrja në programe të ndryshme mediale (TV apo radio) që kanë për qëllim sensibilizimin e opinionit për efektet negative të punës së fëmijëve;

## Masa 2: IDENTIFIKIMI DHE REFERIMI FILLESTAR

Faza e Identifikimit është faza e dytë e PSV-së, por faza në të cilët fillon ndërhyrja e targetuar në viktimën. Ajo përfshin tërësinë e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore, lokale dhe qendrore, përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, që përcaktojnë se një person i/e mitur është viktimë e mundshme e punës së fëmijëve. Kjo masë përfshin kontaktin me fëmijën dhe potencialisht

familjen e fëmijës, vlerësimin e shpejtë të situatës së fëmijës, mbledhjen e informacionit për fëmijën dhe situatën familjare, mbledhjen e informacionit për punëdhënësin e dyshuar, informimin e kujdesshëm të fëmijës (dhe potencialisht familjes) për të drejtat dhe ndihmën në dispozicion, për detyrimet që ka shteti për mbrojtjen e tyre, dhe informimin për alternativat e kujdesit për fëmijën.

Identifikimi i fëmijës, viktimë e supozuar e angazhimit në punë të fëmijëve, mund të ndodh si rezultat i një ngjarjeje të vetme (një dëshmitar e raporton rastin) apo mund të jetë identifikim pas përcjelljes së fëmijës në disa raste të mundshme. Ndaj edhe informacionet në dispozicion me rastin e identifikimit dhe referimit mund të jenë të mangëta apo më të detajuara. Cilado qoftë situata, me rastin e referimit, shërbimet përkatëse sociale do të duhet të vendosin kontakt me fëmijën viktimë e supozuar, dhe duhet të jenë të vetëdijëshëm që ky fëmijë mund të jetë i pashoqëruar ose i shoqëruar nga ndonjë i rritur.

Organi përgjegjës për referimin fillestar është institucioni që vepron si pikë e referimit dhe mbështetjes fillestare (shkolla, mjekësia familjare, policia, OJQ-të, etj) dhe që duhet të reagojë në rastin e referuar. Në këtë rast, njoftimi fillestar duhet t'i bëhet edhe insitucionit përgjegjës, që mban përgjegjësi në lidhje me mbrojtjen e fëmijës (Qendra për Punë Sociale). Roli i autoriteteve të mbrojtjes së fëmijës mund të merret përsipër edhe nga degë të specializuara të policisë, megjithatë gjithmonë në koordinim me QPS-të. Pavarësisht se kush është i pari që identifikon fëmijën viktimë, detyrimi për të informuar autoritetet përkatëse të mbrojtjes së fëmijës (QPS-në në këtë rast) dhe marrja e masave për caktimin e një menaxheri të rastit është e një rëndësie parësore dhe duhet të realizohet para se të ndërmerren masat e tjera. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, cdo person që vëren ose ka informacion për një situatë ose akt që mund fëmija mund t'i nënshtrohet, ose

që ndaj fëmijës është ushtruar ndonjë formë e dhunës fizike ose mendore, keqtrajtim, braktisje, abuzim, neglizhim dhe shfrytëzim është i obliguar që të raportojë rastin, me shkrim ose gojarisht në polici ose në Qendrën përkatëse për punë sociale (Neni 26, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës).

Viktima e supozuar referohet (ose ka raste edhe kur vet-referohet) pranë organit përgjegjës (QPS) për identifikim fillestar.

Një fëmijë i angazhuar në punë të fëmijëve mund të vijë në vëmendje të shërbimeve zyrtare me anë të mjeteve të ndryshme: nga vet viktima, nga personat fizik, nga personeli i zbatimit të ligjit, shkollat, personeli i kujdesit shëndetësor, organizatat e ndryshme joqeveritare, jo-fitimprurëse, organizatat fitimprurëse, inspektorët e punës, inspektorët e zhvillimit rural apo ata të pylltarisë, ofruesit tjerë të shërbimeve, etj. Synimi i identifikimit dhe referimit fillestar është që fëmija të mbërrijë deri tek shërbimet e duhura mbështetëse në mënyrën më të mirë e më të sigurtë të mundshme.

Referimi parasheh raportim zyrtar të një shqetësimi për një fëmijë në rrezik të dëmtimit nga ndonjë person, profesionist, institucion ose organizatë brenda komunitetit. Referimi i fëmijës mund të bëhet drejtpërdrejt në QPS, përmes telefonit ose mjeteve të tjera të komunikimit. Sipas Kornizës së Standardeve Minimale për Shërbimet e Punës së Fëmijëve, çdo partner i mandatuar rastin e identifikuar do t'ia paraqes QPS-së brenda një maksimumi prej 24 orësh nga koha e identifikimit të rastit të tillë.

Për çdo rast të referuar këto struktura duhet të plotësojnë formularin përkatës (Forma E1: Referimi i rastit), nga Udhëzuesi për Menaxhimin e Rastit, që ndodhet në shtojcën e kësaj PSV-je. Forma e plotësuar dërgohet në QPS dhe të dhënat e rastit regjistrohen në Databazë. Në rastet kur referimi bëhet me telefon, dhe njoftohen organet përgjegjëse për një rast, njoftohen edhe punonjësit e rendit (për rastet që kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme) dhe fëmija mirret në mbrojtje.

Gjatë referimit apo vet-referimit ofrohet informacioni bazë për gjendjen e fëmijës dhe nevojat e tij/saj për mbrojtje dhe mbështetje. Fëmija mund të jetë i shoqëruar nga një i rritur si: njëri ose të dy prindërit, kujdestarë ligjorë, të afërm ose persona të familjes, të njohur të prindërve dhe/ose të fëmijës, fqinjë, shok/shoqe e fëmijës, etj.

Informacioni bazë i nevojshëm për referimin e rastit përmban informacione mbi mënyrën se si mund të qasemi te fëmija, informacione thelbësore në lidhje me arsyen pse bëhet referimi, rreziqet të cilave fëmija i ekspozohet, detajet për zyrtarin e punës sociale që ka marrë njoftimin dhe datën kur është bërë referimi. Çdo dokument i dorëzuar me rastin e referimit duhet të regjistrohet.

*Pasi rasti është referuar, nëse zyrtarët institucional në bazë të informacionit të mbledhur vlerësojnë se fëmija është viktimë e mundshme e trafikimit ose viktimë e trafikimit, atëherë, vazhdohet procedura sipas PSV-ve për viktimat e trafikimit.*

Në rastet kur identifikohet fëmija dhe ai/ajo është ose jo i shoqëruar nga të rriturit atëherë në kontaktin e parë, zyrtarët e shërbimeve sociale duhet të:

- Të prezantojnë veten dhe rolin e tyre
- Të japin informacion për qëllimin e takimit dhe procedurën që do të ndjekin
- Të sigurojnë fëmijën se janë aty për ta ndihmuar atë dhe familjen e tij/saj
- Të informojnë për procesin dhe për te drejtën e tij/saj për t'u mbrojtur nga rreziqet që paraqet puna në të cilën është angazhuar dhe detyrimin e prindërve dhe të rriturve të tjerë për ta ndihmuar

- Të komunikojnë në mënyrë miqësore dhe në përputhje me pjekurinë moshore të fëmijës
- Të sigurojnë fëmijën se informacioni që do të marrin rreth tij/saj do të mbetet konfidencial dhe do të ndahet vetëm me personat që do të përfshihen për të ndihmuar
- Të pyesin fëmijën nëse është e përshtatshme që të bisedojnë me të në vendin ku ndodhen apo nëse fëmija preferon një vend tjetër ku mund të ndihet i/e sigurtë.
- Të sigurojnë fëmijën se do të vendosen menjëherë në kontakt me familjen dhe/ose të afërmit e tij/saj.
- Të marrin menjëherë në mbrojtje fëmijën

Sapo identifikohet një fëmijë i angazhuar në punë të fëmijëve, ose në rast se ka baza të arsyeshme për të besuar që personi është viktimë e angazhimit në punë të fëmijëve, QPS duhet të emërojë një menaxher rasti për ta shoqëruar fëmijën gjatë gjithë procesit dhe deri sa të gjindet dhe të vihet në jetë një zgjidhje e qëndrueshme në interesin më të mirë të fëmijës (Forma E2: Caktimi i menaxherit të Rastit).

Rekomandohet që i njëjti person të qëndron si menaxher gjatë gjithë procesit.

Në rastet kur fëmija punon në një komunë tjetër nga komuna e origjinës, identifikimi dhe vlerësimi fillestar bëhet nga komuna ku punon fëmija në bazë të kompetencës territoriale, dhe pas takimit të parë automatikisht referohet në shërbimet sociale të komunës së origjinës.

Si pjesë e procesit të regjistrimit, detajet e rastit verifikohen dhe fëmija dhe familja e tij informohen mbi procesin e menaxhimit të rastit, informacionin që duhet të mblidhet, si do të ruhet dhe me kë do të ndahet, përfshirë konfidencialitetin dhe kufijtë e tij. Kjo do t'i mundësojë prindit/kujdestarit të merr vendim të informuar për pranimin e shërbimeve.

Menaxheri duhet të caktohet nga Qendra për Punë Sociale në komunën prej nga vjen fëmija. Në rastet kur fëmija është pa përkujdesje prindërore, QPS duhet të caktojë edhe një kujdestar ligjor. Me qëllim që të kryejnë rolin e tyre me efektivitet, kujdestarët ligjor duhet të

kenë njohuri/ekspertizë mbi kujdesin e fëmijëve dhe një të kuptuar të nevojave të veçanta të fëmijëve pa përkujdesje prindërore.

Roli i një menaxheri nuk është i njëjtë me atë të një kujdestari ligjor. Në rast se është e përshtatshme për një fëmijë që të nisë apo të marrë pjesë në procedura ligjore, atëherë ai apo ajo do të ketë nevojë për një përfaqësues ligjor.

#### **KUR**

Deri në 24 orë pasi supozohet se një fëmijë është i angazhuar në punë të fëmijëve.

#### **KUSH**

Organi që është pika e parë e njoftimit të rastit. Ky organ duhet të njoftojë QPS-në brenda 24 orëve.

Akterë të ndërlidhur në këtë fazë mund të jenë Mësimdhënësit/ këshilltarët e të drejtave të fëmijës në shkolla, punëtorët socialë, inspektorët e punës, inspektorët e pylltarisë, inspektorët e zhvillimit rural, inspektorët komunal, policia, përfaqësuesit e punëtorëve, qendrat shëndetësore, grupet e të rinjve/fëmijëve, OJQ-të, etj.

Këta ofrojnë informata të dorës së parë përmes vrojtimeve/ bisedave eventuale të fëmijëve të përfshirë në Format e Rrezikshme të Punës së Fëmijëve. Në një formë, ky identifikim fillestar para referimit përfshinë gjithashtu një vlerësimin paraprak (preliminar) të situatës (kontakti fillestar dhe vlerësimi pamor i rreziqeve) dhe mbledhje e të dhënave paraprake që mund të jenë informata shumë të rëndësishme gjatë referimit në QPS.

- 
- Pasi rasti është referuar, nëse zyrtarët institucional në bazë të informacionit të mbledhur vlerësojnë se fëmija është viktimë e mundshme e trafikimit ose viktimë e trafikimit, atëherë, vazhdohet procedura sipas PSV-ve për viktimat e trafikimit.

<b>Institucionet e Arsimit</b>	<p>Shkolla duhet të bëjë evidentimin e rasteve të fëmijëve të përfshirë në format e rrezikshme të punës, dhe në vazhdimësi të përcjellë gjendjen psiko-fizike të fëmijëve për të cilët ka dyshime se janë të përfshirë në punë. Këto evidenca ndahen tutje me QPS-të në rast të identifikimit të rasteve konkrete</p> <p>Në rast të identifikimit të rasteve të fëmijëve të përfshirë në forma të rrezikshme të punës, institucionet e arsimit duhet të njoftojnë zyrtarisht QPS-në përkatëse brenda 24 orëve.</p> <p>Varësisht nga situata, në rast të rrezikshmërisë së lartë, institucioni njofton edhe Policinë e Kosovës</p>
<b>Institucionet e Shëndetësisë</b>	<p>Institucionet shëndetësore bëjnë evidentimin e rasteve të identifikuara të fëmijëve që kanë kërkuar shërbim mjekësor për shkak të lëndimit në punë, si dhe bëjnë evidentimin e rasteve të dyshuara gjatë vizitave të rregullta, sistematike familjare dhe shkollore.</p> <p>Në rast të identifikimit të rasteve të fëmijëve të përfshirë në forma të rrezikshme të punës, institucionet e shëndetësisë duhet të njoftojnë zyrtarisht QPS-në përkatëse brenda 24 orëve.</p> <p>Në ndërkohë, nëse nevoja është e dukshme, këto institucione ofrojnë ndihmën emergjente shëndetësore.</p> <p>Varësisht nga situata, në rast të rrezikshmërisë së lartë, institucioni njofton edhe Policinë e Kosovës</p>
<b>Institucionet e Punës (inspektorati)</b> <b>Inspektoratet komunale</b> <b>Institucionet e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural</b>	<p>Inspektorët e punës, inspektorët komunal dhe institucionet e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural bëjnë kontrollimin e vendpunishteve për të parë se çfarë lloje të rreziqeve të punës ekzistojnë dhe cilave nga ato u ekspozohen fëmijët që punojnë, duke përdorur një mori instrumentesh të zakonshme (kriteret kyçe përfshijnë moshën e fëmijës, vijimin në shkollë dhe kushtet e punës).</p> <p>Në rast të identifikimit të fëmijëve në aktivitete që janë në kundërshtim me ligjet në fuqi, inspektorët e punës, inspektorët komunal si dhe nga agjencitë ekzekutive të MBPZHR njoftojnë qendrën për punë sociale brenda ditës (në rastet kur personi është nën moshën 15 vjeçare) dhe brenda 24 orëve në rastet kur personi është në moshën 15-18 vjeçare.</p> <p>Në rastin e dytë, inspektorati i punës mund të njoftojë të miturin me masat mbrojtëse, aktivitetet e lejuara dhe të ndaluara punuese dhe shërbimet që ofrohen nga QPS-të dhe ZP-të.</p> <p>Varësisht nga situata, në rast të rrezikshmërisë së lartë, inspektorati njofton edhe Policinë e Kosovës</p>
<b>Institucionet e rendit</b>	<p>Institucionet e rendit (p.sh. policia) bëjnë identifikimin (përmes patrollimeve, lajmërimeve nga qytetarët dhe gjatë trajtimit të rasteve tjera) dhe evidentimin e rasteve në procesverbalet zyrtare.</p> <p>Në rast të identifikimit të rasteve të fëmijëve të përfshirë në forma të rrezikshme të punës, institucionet e sigurisë duhet të njoftojnë zyrtarisht QPS-në përkatëse brenda 24 orëve.</p> <p>Poashtu për cdo rast që referohet ne Polici, Policia duhet të njoftojnë QPS-në përkatëse menjëherë pas marrjes së referimit.</p>
<b>OJQ-të, institucionet e ofrimit të shërbimeve sociale dhe grupet tjera</b>	<p>Në rast të identifikimit të rasteve të fëmijëve të përfshirë në forma të rrezikshme të punës, OJQ-të dhe institucionet e ofrimit të shërbimeve sociale duhet të njoftojnë zyrtarisht QPS-në përkatëse brenda 24 orëve.</p> <p>OJQ-të dhe institucionet e ofrimit të shërbimeve sociale bëjnë evidentimin e rasteve të identifikuara të fëmijëve</p> <p>Varësisht nga situata, në rast të rrezikshmërisë së lartë, institucioni njofton edhe Policinë e Kosovës</p>

**SI**

Pika e parë e njoftimit zyrtar (Qendra për Punë Sociale) duhet t'u bëhet e ditur të gjitha institucioneve dhe organizatave përkatëse të lartëcekura, që mund të bien në kontakt me fëmijën/të miturin. Cilido nga institucionet që vie në kontakt me fëmijën/të miturin, dhe ka informacion mbi angazhimin e tij/saj në punë të këqija e njofton QPS-në përkatëse brenda ditës. Referimi bëhet përmes formularit përkatës, përpos në rast se referimi bëhet nga qytetarët e rastit, kjo mund të bëhet edhe vetëm përmes telefonatës, e-mailit, apo modaliteteve tjera në dispozicion.

**► Ndarja e informacionit me viktimën e supozuar dhe me të tjerët**

Ndarja e informacionit me të tjerë është një komponent thelbësor i referimit. Pika e parë e njoftimit duhet t'ua japë informacionin të tjerëve (akterëve përkatës- policia, prokuroria, inspektorati, etj) dhe t'i trajtojë menjëherë nevojat urgjente të viktimave të supozuara.

Institucioni identifikues nuk duhet t'i bëjë pyetje apo të marrë në pyetje fëmijën përsa kohë që QPS nuk është njoftuar dhe viktimia nuk është informuar plotësisht mbi të drejtat e saj/të tij, mbi opsionet, mbi proceset në vijim, mbi mundësitë e saj/të tij që të për të bërë pyetje, për të shprehur shqetësimet dhe paraqitur kërkesat.

Në të gjitha fazat, ata persona zyrtarë (QPS dhe policia) që marrin në pyetje dhe intervistojnë fëmijën/të miturin duhet të tregohen të kujdesshëm për gjuhën që

përdorin, t'i flasin fëmijës me një gjuhë që t'i përshtatet moshës dhe aftësive mendore të fëmijës. Rekomandohet që personat që intervistojnë fëmijët të jenë zyrtarë të trajnuar në drejtim të mënyrave të intervistimit të fëmijëve dhe ta drejtojnë vetë të gjithë seancën e bërjes së pyetjeve dhe të intervistimit.

Dhënia e informacionit duhet të jetë një proces i shtruar, pa presion dhe i hapur shkëmbimi, gjatë të cilit personi që ofron informacionin duhet ta bëjë atë në mënyrë të qartë, profesionale dhe me durim, duke nxitur në këtë mënyrë viktimën e supozuar që të bëjë pyetje dhe të kuptojë drejt qëllimin e personit zyrtar që jep informacionin dhe që u përgjigjet pyetjeve të viktimës.

Të gjithë fëmijët/të miturit e identifikuar dhe të referuar duhet të trajtohen si viktimia.

## Masa 3: VLERËSIMI I RASTIT (fillestar dhe gjithëpërfshirës)

Menaxheri i rastit (MR) bazuar në vlerësim paraprak të situatës së dhënë, hap rastin dhe planifikon procesin e vlerësimit. Vlerësimi i rastit vendos bazën për tërë procesin e menaxhimit të rastit. Mbledhja e fakteve dhe dëshmive gjithëpërfshirëse që përcaktojnë planin e shërbimeve për fëmijën është thelbësore sa i përket vlerësimit të duhur të nevojave dhe kapaciteteve dhe sa i përket formulimit të planeve për ofrimin e ndihmës më të përshtatshme.

### Vlerësimi Fillestar

Vlerësimi fillestar ka për qëllim identifikimin e rrezikut të menjëhershëm dhe përcaktimin e veprimeve prioritare të shpëtimit. Të dhënat që duhet të mbledhen për këtë qëllim përfshijnë: informacione të përgjithshme për fëmijën, informacione mbi natyrën e punës (sektori dhe rreziqet që i ekspozohet fëmija) dhe kategorizimi i nivelit të rrezikut. Procesi fillestar i vlerësimit do të përfundohet nga MR brenda 2 orëve.

Vlerësimi bëhet fillimisht përmes intervistës fillestare, qëllimi i të cilës është të konfirmojë dyshimet, të bëjë shqyrtimin e hershëm të rrezikut potencial për fëmijën/ të miturin, dhe të përcaktojë veprimet prioritare. Vlerësimi fillestar bëhet sipas formularit përkatës nga Udhëzuesi për Menaxhimin e Rastit.

Para intervistës me fëmijën, QPS merr në shqyrtim rrethanat në të cilat fëmija është angazhuar në punë të këqija dhe aktivitetin që ai/ajo kryen. Në këtë rast, zyrtarët e shërbimeve sociale nga informatat e mbledhura deri në këtë pikë, përcaktojnë kryesisht:

- llojin e aktivitetit/punës që kryen fëmija,
- vendin, shpeshësinë dhe kohën kur e kryen këtë punë,
- nëse është i shoqëruar ose jo me fëmijë të tjerë ose persona të rritur;
- dhe nivelin e rrezikut për shëndetin dhe sigurinë e fëmijës.

Vendosja e kontaktit të parë me vetë fëmijën si dhe personat e rritur që mund ta shoqërojnë atë, mund të jetë sfiduese. Fëmijët mund të mos pranojnë menjëherë të bisedojnë me zyrtarët e shërbimeve sociale, ose edhe kur pranojnë të bisedojnë mund të mos bien dakord që të përfitojnë nga ndihma e ofruar. Për

rrjedhojë, zyrtarët në fjalë duhet të jenë të përgatitur për rezistencë të mundshme nga ana e përfituesve dhe të përdorin aftësi dhe teknika komunikimi e negociimi, për të vendosur një marrëdhënie të mjaftueshme besimi që në kontaktin e parë. Në këtë proces, zyrtarët mund të hasin raste kur fëmijët janë të pashoqëruar nga të rritur, pra janë vetëm, ose raste kur fëmijët janë të shoqëruar nga të rritur.

Gjatë kësaj interviste, përpos konfirmimit të dyshimeve, qëllimi është që të mësohet nëse ka ndonjë rrezik të shpejtë për shëndetin dhe sigurinë e fëmijës, ku ndër të tjera vlerësohen edhe rreziqet për fëmijën nga mjedisi, mjetet, natyra apo kohëzgjatja e punës. Shqyrtimi i rrezikut është një diskutim i dyanshëm midis MR dhe viktimës së supozuar, dhe palëve tjera të përfshira.

### Kjo intervistë synon të:

1. Të vendosë një marrëdhënie besueshmërie me fëmijën dhe/ose të rriturit që e shoqërojnë në mënyrë që të nisin procesin aktiv të daljes nga situata e punëve të këqija;
2. Të vlerësojë nivelin e rrezikut, me anë të të cilit do të përcaktohet edhe niveli i ndërhyrjes së menjëhershme.

Në çdo rast zyrtari që udhëheq intervistën duhet të krijojë një atmosferë të përshtatshme, ku fëmija dhe/ose i rrituri ndihen të qetë dhe aspak të kërcënuar gjatë bashkëbisedimit.

Gjatë bashkëbisedimit me fëmijën (dhe/ose të rriturit që e shoqërojnë në momentin e intervistës), merret informacion i detajuar për:

- situatën e përgjithshme të fëmijës dhe nevojat bazë
- llojet e aktiviteteve që kryen fëmija në punë dhe arsyet,
- kohën dhe shpeshësinë e frekuentimit të asaj pune,
- personat kyç me të cilët është i/e lidhur dhe shoqërohet në punë
- gjendjen e përgjithshme psiko-fizike të fëmijës
- të dhëna të përgjithshme për familjen dhe të afërmit (nëse ka)



Përveç menaxherit të rastit, mund të jetë e nevojshme që të përfshihen edhe përfaqësues tjerë të shërbimit social. Nëse vlerësimi nxjerr në pah se niveli i rrezikut është i mesëm ose i ulët, që do të thotë se nuk ka rrezik të menjëhershëm për jetën ose sigurinë e fëmijës, atëherë MR do të vazhdojë me vlerësimin. Nëse niveli i rrezikut është i lartë atëherë fillimisht nevojitet veprim i menjëhershëm për ta shpëtuar fëmijën nga rreziku.

Shqyrtimi i hershëm i rrezikut për fëmijën duhet të ndërmerret duke patur parasysh se veprimet që do të kryhen, do të realizohen sipas interesit më të mirë të fëmijës. Kjo përjasje do të jetë në mënyrë të veçantë, përgjegjësi e menaxherit, dhe vendimet që do të marrë ai apo ajo dhe që lidhen me respektimin e kësaj të drejte të fëmijës, duhet të jenë prioritet.

Intervista nuk duhet të përjetohet si një rast që e vendos fëmijën dhe/ose të rriturit në shënjestër, që ka për qëllim vetëm marrjen e informacionit, që shkakton pasoja traumatike ose shqetësuese ose që perceptohet si ndërhyrëse në jetën personale dhe familjare të tyre. Bashkëbisedimi bëhet gjithmonë nga menaxheri i rastit, ndërsa një person tjetër mban shënime në formën e intervistës.

### KUR

Intervista fillestare kryhet sa më shpejtë që është e mundur pas referimit. Arsyeja për këtë nxitim është që duhet të përcaktohet nëse fëmija ka nevojë për shërbime bazike dhe mbrojtje të menjëhershme. Intervista nuk kryhet nëse fëmija:

- e refuzon atë, nëse fëmija është në gjendje jostabile psikike,
- ka dhimbje apo ndjenjë pasigurie,
- ka nevojë për ndërhyrje të menjëhershme mjekësore,
- kërkon të ketë pranë ndonjë person specifik (p.sh. familjarë), apo
- ndodhet në ndonjë vend ku nuk mund të sigurohet konfidencialiteti.

### KUSH

Intervistën e kryen zyrtari nga QPS, idealisht menaxheri i rastit. Nëse nuk është caktuar deri atëherë menaxheri i rastit, atëherë intervistën e kryen personi zyrtar I caktuar në atë detyrë nga Drejtori I QPS. Në intervistë, varësisht nga rasti mund të merr pjesë edhe Policia e në raste specifike, edhe Prokuroria. Gjatë vlerësimit plotësohet Forma E3: Vlerësimi i Rastit.

### SI

Gjatë të gjitha intervistave që bëhen me fëmijët/ të miturit duhet të mbahen parasysh, si çështje të një rëndësie parësore, mbajtja e qendrimeve etike dhe ofrimi i sigurisë për fëmijët/të miturit.

Intervista fillon me pyetje rreth shëndetit dhe sigurisë së viktimës, pasi në fillim të intervistës ka rëndësi që të sqarohet nëse fëmija është duke vuajtur apo nuk ndihet i qetë. Bërja e pyetjeve rreth shëndetit dhe gjendjes psikofizike nuk është vetëm njerëzore, por, gjithashtu, tregon se shqetësimi parësor i intervistuesit është mirëqënia e fëmijës. Kjo, po ashtu, ndihmon fillimin e fitimit të besimit të fëmijës.

Në rast se shqyrtimi i hershëm i rrezikut tregon se është e nevojshme marrja e masave të veçanta të mbrojtjes, atëherë duhet të ndërmerren veprimet përkatëse sa më shpejt që të jetë e mundur. Masat e sigurisë mund të zbatohen vetëm në rast se informohet plotësisht viktimë rreth këtyre masave dhe vetëm në rast se për këto masa bie dakord dhe viktimë. Në rast se fëmija është në rrezik të lartë për mbrojtje, atëherë zyrtarët sociale duhet të marrin menjëherë në mbrojtje fëmijën.

### Kujdes:

Bëni kujdes sepse fëmija mund të ekspozohet ndaj rrezikut të ndëshkimit nga të rriturit që e shfrytëzojnë sepse ka folur ose është kontaktuar nga QPS!

Gjatë bashkëbisedimit fillestar (intervistës) dhe në vazhdim duhen mbajtur parasysh këto 5 rregulla kryesore:

1. Mos dëmtoni fëmijën në asnjë nga fushat e zhvillimit (kognitiv, emocional, social/moral, fizik) përmes ndërhyrjes tuaj

2. Kontribuoni pozitivisht në zhvillimin e fëmijës në të gjitha fushat përmes ndërhyrjes tuaj
3. Mbani parasysh kapacitetet në evoluim të fëmijës – një fëmijë 7 vjeçar ka një nivel të ndryshëm zhvillimi nga një fëmijë 17 vjeçar.
4. Mbani parasysh individualitetin e çdo fëmije - edhe fëmijët e së njëjtës moshë kanë aftësi të lindura të ndryshme nga njëri-tjetri dhe për më tepër disa prej tyre mund të mos kenë patur mundësi të njëjta për zhvillim për shkak të mënyrës së rritjes.
5. Mos gjykoni fëmijët dhe/ose të rriturit për situatën në të cilën ndodhen. Jeni atje për të ndihmuar të dyja palët.

#### **Përcaktimi i Rrezikut të Menjëhershëm**

Rreziku i menjëhershëm nënkupton që fëmija nuk ka aftësinë që të kujdeset për veten në mënyrë të pavarur dhe nuk ka aftësi vetë-mbrojtëse. Fëmija mund të jetë tërësisht nën kujdestarinë e shfrytëzuesit/detyruesit për punë të këqija dhe nuk ka ndonjë kujdestar tjetër. Fëmija nuk ka dëshirë të kthehet në shtëpi ose mund të jetojë jashtë shtëpisë ose pa mbikëqyrjen e të rriturve (siç është rasti i fëmijëve që jetojnë në rrugë). Megjithatë, është e nevojshme që të bëhet një analizë e faktorëve të rrezikut ndaj të cilëve fëmija i angazhuar në punë të këqija është më shumë i ekspozuar, për të përcaktuar llojin e ndihmës që do t'i ofrohet në momentin e identifikimit.

Këto faktorë përfshijnë përmbledhtazi: moshën e fëmijës, zhvillimin e përgjithshëm, gjëndjen psikofizike në momentin e identifikimit, llojin e aktivitetit në punë, kohën e identifikimit, lidhjen me familjen, prezencën ose jo të të rriturve dhe lidhjen e fëmijës me ta, si dhe faktorët mjedisit.

Pas përfundimit të vlerësimit, në bazë të vëzhgimit dhe bashkëbisedimit me fëmijën dhe/ose të rriturit që e shoqërojnë atë, zyrtarët e shërbimeve sociale gjykojnë për formën dhe mënyrën e ndihmës së menjëhershme të fëmijës. Forma dhe mënyra e ndihmës së menjëhershme përcaktohet në varësi të gjëndjes së përgjithshme shëndetsore, fizike, emocionale dhe të sigurisë së fëmijës dhe nivelit të rrezikut.

#### **Ndihma e menjëhershme mund të përfshijë:**

1. Shoqërimin e fëmijës në familje kur vlerësohet se ambienti familjar nuk përbën rrezik për fëmijën

TREGUESIT (faktorët e rrezikut): gjendja shëndetësore është e mirë, gjendja psiko-emocionale është stabile, nuk ka aftësi të kufizuara, ka sjellje të qetë, komunikon mirë, nuk shfaq varësi nga ndonjë substancë, pas punës kthehet rregullisht në shtëpi, kryen punë vetëm gjatë ditës dhe kryesisht jashtë orarit shkollor ose në fundjavë.

1. Shoqërimin e fëmijës për marrjen e shërbimeve ose vendosjen e fëmijës në shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës

TREGUESIT: paraqet shenja të sëmundjes fizike, nuk është i/e veshur mirë, ka të ftohtë, është i/e zbatuar, fëmija është i/e hutuar, nuk flet ose ka frikë të shtuar, ka probleme të dukshme të zhvillimit mendor ose fizik, nuk është i/e qetë, qan, flet pa pushim, ngacmon të tjerët, duket se është në efektin e ndonjë substancë, dyshohet se punon edhe gjatë orarit të shkollës dhe në orët e vona.

1. Shoqërimin e fëmijës në shërbimin shëndetësor të urgjencës për fëmijë dhe vendosja në strehim alternativ

TREGUESIT: në gjendje të rënduar shëndetësore, ose në gjendje kritike për jetën, ka shenja të traumës, dëmtime fizike, është i/e urritur, i/e paveshur, qan, ka frikë të shtuar, nuk pranon të flaës, ka probleme të dukshme të zhvillimit fizik dhe mendor, ka sjellje agresive ose plotësisht të tërhequr, është nën efektin e substancave, rrallë shkon në shtëpi, punon gjatë gjithë ditës dhe natës.

Lista e treguesve të paraqitur nuk është shterruese. Secili prej këtyre treguesve ka një peshë dhe rëndësi për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijës. Prandaj ata duhen marrë në konsideratë dhe analizuar një nga një kur merret vendimi për ndihmën e menjëhershme. Marrja e vendimit për llojin e ndihmës nuk duhet të kushtëzohet nga prezenca ose jo e të gjithë faktorëve të rrezikut që bien nën secilën kategori. Ka raste kur situata e fëmijës paraqet prezencën e kombinuar të faktorëve nga të treja kategoritë. Në të tilla raste, prezenca e faktorëve të rrezikut të lartë merr përparësi në marrjen e vendimit.

Në rastet kur zyrtarët e shërbimeve sociale, krijojnë bindjen apo kanë dyshime se ndaj fëmijës së identifikuar në punë të këqija është kryer një veprë penale, atëherë për rastin njoftohet Policia e Kosovës. Në rastet kur kërkohet një ndërhyrje emergjente njoftimi kryhet nëpërmjet telefonit, ndërsa në rastet e tjera njoftimi bëhet me shkrim duke dërguar materialet si më poshtë:

- Informacion mbi njoftimin për rastin (këtu duhet të jepet një përmbledhje mbi rastin, data, ora, vendi i konstatimit, gjeneralitetet e fëmijës, nëse ka gjeneralitetet e personave të dyshuar, konstatimet e bëra, arsyet dhe shkaqet që kanë çuar bindjen apo dyshimin se ndaj fëmijës së identifikuar është kryer një veprë penale dhe të marrin vendim për denoncimin e rastit, etj).
- Formularë, procesverbale ose dokumenta të tjera që janë mbajtura në lidhje me rastin.

Policia e Kosovës me marrjen e informacionit, organizojnë punën për marrjen në mbrojtje të fëmijës. Së bashku me QPS-në, mirret vendimi për vendosjen e fëmijës në kujdes familjar apo alternativ. Njëkohësisht, organizohet puna për kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore e procedurale për dokumentimin e veprës penale dhe referimin e materialeve Prokurorisë.

Lidhje të posaqme duhet të vendosen me prokurorinë dhe gjykatat në rast se a/ fëmija mund të ofroj informacion si dëshmitar në ndonjë rat kriminal, b/ fëmija është vet në kundërshtim me ligjin, c/ të drejtat prindërore duhet të mirren (përkohësisht) për shkak të rrezikut të drejtpërdrejtë për sigurinë e fëmijës.

### **Vlerësimi Gjithëpërfshirës**

Vlerësimi gjithëpërfshirës është vlerësim i thelluar që synon t'i japë MR kuptim tërësor të situatës së fëmijës, të gjenerojë informacion për të udhëzuar zhvillimin e planit të shërbimeve dhe për t'i identifikuar aspektet që mund të përdoren për të informuar vendimet e MR lidhur

me natyrën e ofruesve të tjerë të shërbimeve që mund të ndërhyjnë në situatën e fëmijës për t'i adresuar shqetësimet specifike. Vlerësimi duhet të mbulojë nevojat fizike, psikologjike, emo-

cionale dhe sociale, duke përfshirë të kuptuarit e karakteristikave kulturore të mjedisit, si dhe hartëzimin e shërbimeve në dispozicion në komunitetin ku fëmija jeton.

Vlerësimi i nevojave duhet të bëhet në konsultim të ngushtë me fëmijën dhe familjen e tij. Si rrjedhojë, hapi i parë dhe më i rëndësishëm është angazhimi dhe krijimi i marrëdhënies me fëmijën, ndërtimi i besimit dhe bërja e situatës sa më të përshtatshme dhe të sigurt. Si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm, MR duhet të krijojë dosje të të gjitha të dhënave, informacioneve dhe përfundimeve përkatëse për profilin e rastit bazuar në ato informacione. Përmbajtja e dosjes së fëmijës ruhet në fshehtësi të lartë dhe vihet në dispozicion vetëm për profesionistët që janë duke punuar mbi rastin.

Vlerësimi gjithëpërfshirës është një vlerësim më i plotë i cili përqëndrohet kryesisht tek nevojat e fëmijës, të familjes dhe të sigurisë së tyre, i cili përipiqet të identifikojë:

- Rrezikun ndaj fëmijës në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë;
- Nevojat e gjithanshme të fëmijës në lidhje me moshën dhe zhvillimin e tyre;
- Pikat e forta, kapacitetet dhe burimet e familjes (sipas rastit, përfshirë edhe familjen e gjerë).

Është e rëndësishme të theksohet se vlerësimi gjithëpërfshirës ndryshon nga hetimi i cili mund të ndërmerret nga policia lidhur me abuzimin në mënyrë që një shkelës të ndiqet penalisht.

Vlerësimi gjithëpërfshirës bëhet nga zyrtarët e shërbimeve sociale, në ambiente miqësore për fëmijët. Në cdo rast, zyrtarët duhet të përdorin format e vlerësimit të përcaktuara në udhëzuesin për menaxhimin e rastit.

Qëllimi përfundimtar i këtij vlerësimi është të fiitohet pasqyra e plotë e nevojave dhe aftësive të fëmijës, dhe të hartohet plani individual i shërbimeve, një plan i mbrojtjes dhe përkujdesit individual për fëmijën dhe potencialisht familjen.

Plani individual i shërbimeve hartohet edhe në rastet kur fëmija shoqërohet në familje edhe në rastet kur fëmija vendoset në strehim jashtë familjes. Strehimoret nuk janë, zakonisht, zgjidhja

më e mirë për fëmijët viktime, me përjashtim të qëndrimit vetëm për periudha shumë të shkurtëra. Për fëmijën duhen kërkuar mënyra të tjera të sistemit dhe përkujdesjes, duke shfrytëzuar mekanizmat ekzistues të mbrojtjes së fëmijëve që nuk gëzojnë kujdesin prindëror. Strehimi familjar ose tek të afërmit është zgjidhje më e përshtatshme.

#### **KUR**

Pasi është bërë shoqërimi i fëmijës në familje (biologjike apo alternative) dhe është ofruar kujdesi emergjent për fëmijën. Vlerësimi gjithëpërfshirës do të përfundojë brenda 7 ditëve, nga momenti i hapjes së rastit. Në këtë proces MR do të përdorë: - Intervista/diskutime me fëmijën, prindërit/kujdestarin, anëtarët e tjerë të familjes, mësuesin dhe palët e tjera, sipas rastit dhe sipas nevojës; dhe Vëzhgimin (p.sh. i shëndetit fizik të fëmijës, mirëqenia emocionale dhe mendore, cilësia e kushteve të banimit).

#### **KUSH**

Menaxheri i Rastit, me ndihmën e ekipit profesional në dhe jashtë QPS-së të cilët ofrojnë informacionet relevante nga evidencat e tyre, p.sh. Institucionet arsimore mbi vijueshmërinë e fëmijës në shkollë, suksesin, vështirësitë eventuale, apo Institucionet shëndetësore mbi dosjen shëndetësore të fëmijës, vlerësimin e gjendjes shëndetësore dhe psikofizike, etj.

Analiza e vlerësimit të nevojave bëhet duke krahasuar të dhënat nga shkolla/familja/vendi i punës, këshillimi me fëmijën dhe familjen e saj/ tij si dhe të dhënat për numrin e shërbimeve në dispozicion.

#### **SI**

Pasi është bërë shoqërimi i fëmijës në familje (biologjike apo alternative), MR bën vizitën në familje dhe merr informacion më të plotë për fëmijën nga akterët e tjerë.

Informacioni i parë i mbledhur është për perceptimet e fëmijës mbi punën dhe arsyet e angazhimit në punë. Të dhëna të tjera që mund të mblidhen gjatë vlerësimit gjithëpërfshirës dhe intervistës me fëmijën përfshijnë: të dhënat mbi problemet shëndetësore dhe trajtimin shëndetësor, perceptimet e fëmijës në lidhje

me familjen e tij dhe marrëdhëniet shoqërore, të dhënat mbi arsimimin, përdorimin e kohës së lirë dhe interesat e fëmijës, qëllimet/perspektiva e fëmijës për të ardhmen e tij/saj, etj. Intervistat me fëmijën nuk duhet të zgjasin më shumë se 45 minuta.

Intervista me prindërit/kujdestarët duhet të përqendrohet në mbledhjen e të dhënave mbi profilin e familjes, kushtet e banimit, ushqyerjen, burimet e të ardhurave të ekonomisë familjare, perceptimin e prindërve për punën e fëmijëve, qëllimet/perspektivën e prindërve për fëmijën e tyre, etj. Në këtë drejtim, duhet të vlerësohet edhe aftësia e familjes për të mbështetur tërheqjen dhe riintegrimin e fëmijës nga puna e fëmijëve: në çfarë mase është familja një faktor mbështetjeje dhe ndihme për rimëkëmbjen e fëmijës ose, përkundrazi, një pengesë. Nëse është e nevojshme duhet të organizohen intervista të veçanta me prindërit (nënë dhe babanë). Anëtarët e tjerë të familjes mund të intervistohen gjithashtu për të pasur një perspektivë më të gjerë të situatës. Ky vlerësim duhet së pari të përcaktojë nëse fëmija është në rrezik të drejtpërdrejtë duke qëndruar pranë familjes së tij dhe nëse duhet të kërkohej një urdhër gjyqësor për një pezullim (të përkohshëm) të të drejtave prindërore.

Menaxheri i Rastit poashtu mbledh mendimet dhe rekomandimet e ekspertëve të fushave të ndryshme që kanë pasur rol në vlerësimin e nevojave të fëmijës dhe përgatit një informacion të plotë për rastin, të cilin e ndan me anëtarët e ekipit profesional. Informacioni ndahet të paktën 24 orë përpara thirrjes së takimit me ekipin. Procesi i vlerësimit gjithëpërfshirës duhet të përfundojë brenda 7 ditëve nga dita e vlerësimit fillestar të rastit. Ekipi mblidhet brenda 2 ditëve nga përfundimi i vlerësimit gjithëpërfshirës. Në ndërkohë, menaxheri i rastit adreson nevojat urgjente të fëmijës/familjes.

## Masa 4: PLANIFIKIMI I SHËRBIMEVE INDIVIDUALE

Krijimi i një plani të shërbimeve është një përkthim i vlerësimit të kompetencave dhe nevojave të fëmijës në qëllime dhe synime konkrete dhe realiste, duke planifikuar një program trajtimi dhe rehabilitimi bazuar në shërbimet e disponueshme. Plani i shërbimit duhet të jetë baza e një kontrate morale midis fëmijës, prindërve, ofruesve të shërbimeve dhe Menaxherit të Rastit.

Plani individual i shërbimeve është një përshkrim i qartë dhe i hollësishëm i hapave të mëtejshëm të propozuar për kujdesin ndaj fëmijës dhe familjes. Ky plan është, përgjithësisht, një plan i ndërmjetëm pune. Shih shtojcën Forma E4: Plani i Shërbimeve.

Pavarësisht nëse fëmija është marrë menjëherë në mbrojtje dhe është vendosur në një institucion për kujdesi apo është shoqëruar në familje dhe ndiqet nga Menaxheri i Rastit, në çdo rast për fëmijën ka një Plan individual të shërbimeve, ku përshkruhet plani i ndërhyrjes.

Hartimi i Planit Individual duhet të marrë në konsideratë faktorët dhe nivelin e rrezikut të fëmijës, nevojat urgjente si dhe faktorët e kontekstit që bëjnë të mundur rehabilitimin dhe integrimin e plotë të fëmijës në familje dhe komunitet. Për hartimin e tij, menaxheri i rastit duhet të marrë në konsideratë dëshirat dhe këndvështrimet e fëmijës, në përputhje me pjekurinë moshore të tij/saj, si dhe mendimet e prindërve, kujdestarëve apo familjes së gjerë nëse fëmija nuk ka prindër/kujdestarë ligjorë.

Procesi i hartimit të planit udhëhiqet nga parimi i Interesit më të lartë të fëmijës. Përveç adresimit të nevojave individuale të fëmijës, një konsideratë të veçantë duhet të marrë edhe puna me familjen (prindërit, kujdestarët ligjorë ose të afërmit) në mënyrë që rehabilitimi dhe reintergrimi i fëmijës në familje dhe komunitet të jetë i suksesshëm dhe i qëndrueshëm.

Kur përgatitet plani i shërbimeve, është e rëndësishme të mos shihen vetëm nevojat e fëmijës, por të njihet potencialin e tij për kapërcim të situatës. Në këtë drejtim, barrierat e identifikuar duhet të adresohen nga strategjitë për t'i kapërcyer ato dhe pikat e forta të identifikuar duhet të adresohen nga strategjitë për t'u mbështetur mbi to. Një pjesë e këtij potenciali në të vërtetë mund të vijë nga përvoja e

fëmijës si fëmijë punëtor. Në këtë rast, MR duhet të jetë i kujdesshëm që riaktivizimi i përvojës së punës së fëmijës të mos riaktivizojë traumën e lidhur (nëse ka).

Në mënyrë që puna me familjen për rehabilitimin dhe reintergrimin e fëmijëve të jetë e suksesshme, ndërhyrjet për mbështetjen e familjeve duhet të bazohen tek parimet e mëposhtme:

- Rikthimi në familje është gjithmonë zgjedhja e parë, kur kjo është në interesin më të mirë të fëmijës
- Çdo ndërhyrje në mbështetje të familjes duhet të ketë fëmijën në qendër që do të thotë se fëmija është i/e përfshirë, se ajo i përgjigjet nevojave të fëmijës dhe është në interesin më të lartë të tij/saj.
- (Ri)Vendosja e marrëdhënieve pozitive ndërmjet fëmijës dhe prindërve/kujdestarëve është kusht thelbësor për qëndrueshmërinë e ndërhyrjes
- Përfshirja e akterëve kyc në komunitet sjellë një mbështetje më të gjerë për fëmijën dhe familjen

Në të gjitha rastet zyrtari që është edhe menaxheri i rastit duhet të bëjë një vlerësim të kujdesshëm të situatës familjare dhe faktorëve të kontestit për të konfirmuar nëse familja është një mjedis i sigurtë për fëmijën. Ky vlerësim duhet të përfshijë të gjitha aspektet e mirëqenies së fëmijës dhe duhet të përdoret si një dokument bazë për të krahasuar progresin e arritur si rezultat i mbështetjes.

### KUR

Plani i shërbimeve duhet të hartohet brenda 14 ditëve nga vlerësimi i përfunduar.

### KUSH

Menaxheri i Rastit me ndihmën e ekipit profesional në dhe jashtë QPS-së. Në hartimin e planit, merr pjesë edhe fëmija dhe familja.

Përderisa QPS, respektivisht Menaxheri i Rastit është përgjegjës për menaxhimin e shërbimeve që dalin nga plani e që janë në përputhje me interesin më të mirë të fëmijës, akterët tjerë mbartin poashtu përgjësitet e tyre konform mandatit që kanë.

Në raste specifike, plani i shërbimeve hartohet në kuadër të TMR-së. Profesionistët që mund të përfshihen në TMR dhe përgjegjësitë e tyre janë detajuar në UA për Tryezat e Menaxhimit të Rastit.

### Menaxheri i Rastit

Udhëheqë procesin për planifikimin e shërbimeve individuale për fëmijën, për të siguruar mbrojtjen, rehabilitimin, risocializimin dhe mirëqenien fëmijës

- Është përgjegjës për identifikimin e shërbimeve ekzistuese në komunë (publike, jopublike dhe private) dhe vendos bashkëpunimin për referimin e rasteve të fëmijëve në punë apo familjarëve të tyre për shërbime të ndryshme varësisht nga nevojat e identifikuar;
- Planifikon bashkëpunimet me shkolla dhe me ofruesit tjerë të shërbimeve për të mbështetur në mënyrë reciproke reintegrimin social dhe arsimor të fëmijëve
- Planifikon hapa konkret për të mbështetur familjet në jetësimin e përgjegjësive e tyre për rritjen e fëmijëve, duke ju ofruar këshillime mbi prindërimin pozitiv;

### Institucionet Arsimore

- Planifikojnë mbështetjen e individualizuar edukative për tërheqjen e fëmijëve nga puna;
- Identifikojnë barrierat e qasjes në arsim në nivel shkollë, planifikojnë intervenimet në nivel shkollë dhe propozojnë masat për DKA-të dhe MASHTI;
- Planifikojnë aktivitete sensibilizuese për nxënësit për problemin
- Planifikojnë bashkëpunimet me ofruesit tjerë të shërbimeve dhe partnerët (policinë, QPS-të, OJQ-të që ofrojnë programe edukative dhe që kanë në fokus mbrojtjen e fëmijëve, bizneset, etj) me qëllim largimin nga puna të fëmijëve që kombinojnë shkollën dhe punën apo/dhe kthimin e reintegrimit në fëmijëve të cilët e kanë braktisur shkollën;

### Institucionet Shëndetësore

- Planifikojnë aktivitete këshilluese për prindërit ose kujdestarët dhe anëtarët tjerë të familjes së fëmijëve të lënduar në punë për rreziqet e aktiviteteve të caktuara punuese dhe efektet e mundshme të këtyre rreziqeve në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve.
- Planifikojnë bashkëpunimet me institucionet shkollore dhe QPS-të në ofrimin e mbështetjes profesionale në trajtimin e temës së abuzimit ekonomik të fëmijëve dhe pasojat për shëndetin.

### Ofruesit tjerë të shërbimeve

- Planifikojnë ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe familjet
- Identifikojnë zbrastësit në ofrim të shërbimeve brenda komunës ku veprojnë dhe planifikojnë për plotësimin e këtyre zbrastësirave
- Planifikojnë aktivitete të përbashkëta institucionet arsimore, sociale e shëndetësore

### SI

Plani i shërbimeve tregon se si do të ndihmohet fëmija dhe familja për të përmirësuar rrethanat e fëmijës, për të zvogëluar rreziqet me të cilat përballlet fëmija dhe për të përmirësuar aftësitë e prindit / kujdestarit ligjor për t'u kujdesur për fëmijën(-t), duke ruajtur kështu familjen. Ai duhet të përfshijë objektiva për fëmijën dhe anëtarët e tjerë të familjes dhe duhet të kontribuojë në fuqizimin e fëmijës duke e ndihmuar atë të marrë më shumë kontroll mbi jetën e tij dhe mjedisin.

Rasti diskutohet në ekipin multidisciplinarë, dhe hartohet plani bazuar në vlerësimin e menaxherit dhe gjithnjë duke pasë për bazë interesin më të mirë të fëmijës. Në takimin e ekipit multidisciplinar diskutohet:

- Cilat janë nevojat e fëmijës për ndihmë fizike, shëndetësore dhe psikosociale?
- Si do të trajtohet rasti?

- Cilat janë shërbimet e rregullta që I nevojiten fëmijës dhe për sa kohë? Kush do t'i ofroj ato shërbime? Për çfarë periudhe? Kush do të jetë përgjegjës për shërbimet specifike?
- Cila duhet të jetë natyra e strehimit afatgjatë të fëmijës?
- Qështjet e reintegrimit të fëmijës në sistemin arsimor?
- Si bëhet monitorimi i shërbimeve të planifikuara? Nga kush?
- Çfarë të bëhet nëse ka shqetësime për sigurinë e fëmijës?

Në hartimin e planit merr pjesë edhe fëmija dhe familja. Është e rëndësishme që të mirret pëlqimi i tyre që përcakton se ata I kuptojnë këto procedura dhe e japin pëlqimin për marrjen e ndihmës së ofruar dhe për rrethanat dhe kushtet që e shoqërojnë atë ndihmë. Pëlqimi kërkohet pasi të jenë shpjeguar mirë dhe saktë mundësitë dhe rregullat për përfitimin e shërbimit dhe pasi ata të kenë pasur mundësinë të shtrojnë pyetjet e tyre.

Në rastet kur fëmija është në familjen biologjike, puna me familjen zë një vend të vecantë në planin e individualizuar të shërbimeve.

#### **Plani i shërbimeve:**

- përcakton objektivat individuale që janë drejtpërdrejt të rëndësishme për nevojat e fëmijës, të identifikuar gjatë vlerësimit;
- përcakton masa/aktivitete specifike që janë shërbime të nevojshme për t'i përmbushur nevojat dhe qëllimet e fëmijës;
- përcakton tregues të verifikueshëm për secilin aktivitet, në mënyrë që të pasqyrojë rezultatin e aktiviteteve të ndryshme;
- siguron që masat / aktivitetet përcaktojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë, si dhe afatet kohore;
- është realisht i arritshëm brenda një kornize kohore të caktuar për të gjithë akterë

Si i tillë, plani i shërbimeve përfshin këto aspekte:

**Kujdesin** – kjo përfshin përgjigjen ndaj nevojave të menjëhershme dhe bazike të viktimës-vendstrehimin, ushqimin, kontrollat e rregullta mjekësore, masat e sigurisë, bashkërendimin e aktiviteteve me agjensionet tjera, ndihmën ligjore, etj. varësisht nga nevojat individuale të fëmijës

**Mbështetjen direkte për fëmijën të vendosur në strehim alternativ apo në familje** – kjo përfshin ndihmën me shërbime mjekësore, reitegrimin në shkollë (nëse fëmija nuk vijon shkollën), shërbimet mbështetëse brenda shkollës, shërbime psikologjike nëse vlerësohen të nevojshme dhe të tjera të ngjashme varësisht nga nevojat e fëmijës.

**Mbështetjen për prindërit/kujdestarët** – orientim dhe edukim mbi praktikën e mira të mirërritjes dhe prindërimit, çështjet e mbrojtjes së fëmijës, kujdesit shëndetsor dhe mirë-ushqyerje, arsimimi dhe zhvillimi psiko-social i fëmijës.

**Arsimimin dhe trajnimet** – në varësi të moshës së fëmijës dhe nivelit arsimor, menaxheri i rastit në bashkëpunim me prindërit/kujdestarët dhe aktorët kyc në komunitet siguron regjistrimin e fëmijës në shkollë dhe monitoron nëse fëmija frekuenton rregullisht shkollën. Për fëmijët më të rritur (mbi moshën 14 vjec) atëherë mund të shikohet mundësia e ndjekjes së arsimit profesional dhe trajnimeve të aftësisimit për jetën.

**Kujdesin shëndetsor** – Menaxheri i rastit gjatë punës së ngushtë me familjen vlerëson nëse familja është në gjendje të sigurojë kujdes shëndetsor të vazhdueshëm për fëmijën. Në varësi të gjëndjes fizike dhe shëndetsore të fëmijës, menaxheri i rastit ndërmjetëson qasjen në shërbime shëndetsore të vazhdueshme për fëmijën dhe familjen përmes bashkëpunimit me strukturat e këtij shërbimit në nivel vendor.

**Fuqizimin ekonomik i familjes** – forcimi dhe mbështetja e familjes nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk punohet për fuqizimin ekonomik të tyre. Menaxheri i rastit lehtëson regjistrimin e prindërve si punëkërkues të papunë pranë strukturës përkatëse në nivel vendor dhe njëkohësisht sigurohet që familja përfiton nga skema e ndihmës sociale. Ndërkohë, së bashku me anëtarët e rritur të familjes lehtëson procesin e gjetjes së burimeve alternative

përmes bashkëpunimit me aktorë të tjerë vendorë apo organizata të shoqërisë civile. Këto burime mund të gjenerohen përmes Aktiviteteve për Nxitjen e të Ardhurave, projekteve të biznesit social apo Mikro-kredive.

**Angazhimin e komunitetit** – menaxheri i rastit duhet të ndërveprojë dhe bashkëpunojë me aktorët kyç në komunitet dhe institucionet në nivel vendor për të siguruar një mbështetje sa më të gjerë për familjen. Këto aktorë mund të përfshijnë: institucionet e pushtetit vendor, shkollat, policinë, qendrat shëndetsore, institucionet fetare, OJF-te dhe Organizatat me Bazë Komunitare në nivel lokal dhe persona të tjerë me ndikim në komunitet. Punonjësi social duhet të komunikojë me të gjithë këto grupe për të ndërmjetësuar që familja të ketë akses në të gjitha shërbimet që mund t'i nevojiten.

Për fëmijën duhet të përcaktohen objektiva të ndërlidhura individuale afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Një afat kohor potencial për objektivin afatshkurtër mund të jetë 3 muaj, për objektivin afatmesëm nga 4 deri në 12 muaj dhe për objektivin afatgjatë deri në 36 muaj.

Hartimi i një plani të shërbimeve kërkon përfshirjen e akterëve të tjerë të rëndësishëm që mund të ofrojnë mbështetjen dhe ndërhyrjet e nevojshme. Një rol i rëndësishëm i MR në këtë fazë është identifikimi i shërbimeve të duhura dhe masave mbështetëse. Përderisa numri i tanishëm dhe shumëllojshmëria e shërbimeve sociale, si publike ashtu edhe private, janë ende të kufizuara, një rol i rëndësishëm i MR është të avokoj ose të kërkojë ndihmë në emër të fëmijës dhe të rrisë rrjetin e ofruesve të shërbimeve. Kjo do të përfshijë vënien e kontaktit me ofruesit e shërbimeve në dispozicion dhe të mundshëm dhe përshkrimin e nevojave të fëmijës. Një numër referimesh të ndryshme mund të bëhen për fëmijën sipas nevojave të ndryshme të identifikuar.

Të gjitha lidhjet që i mundësohen familjes për marrjen e shërbimeve të ndryshme duhet të dokumentohen dhe të vendosen në dosjen e fëmijës në mënyrë që më pas të bëhet edhe monitorimi dhe përcjella e rastit.

Pasi të identifikohen shërbimet e mundshme, caktohet takimi i Tryezës së Menaxhimit të Rastit<sup>24</sup> (të gjithë akterët e përfshirë në zbatimin e planit të shërbimit) nga MR për të shkëmbyer informacione, për t'i identifikuar pikat e forta dhe

sfidat me të cilat përballen fëmija dhe familja dhe për të rënë dakord për planin e shërbimeve.

### **Marrja e pëlqimit**

Plani duhet të zhvillohet gjithmonë në bashkëpunim me fëmijën dhe familjen. Procedurat e marrjes së pëlqimit përcaktojnë nëse fëmija dhe familja i kuptojnë këto procedura dhe japin pëlqimin, ose jo për marrjen e ndihmës së ofruar, dhe për rrethanat dhe kushtet që e shoqërojnë atë ndihmë. Prindi/kujdestari duhet të jap pëlqimin për planin e shërbimeve duke nënshkruar atë.

### **KUR**

Pasi t'i jenë shpjeguar mirë dhe saktë familjes mundesitë dhe rregullat për përfitimin e shërbimit dhe pasi ajo/ai të kenë patur mundësi të shtrojnë pyetjet e tyre, familja duhet të pyetet nëse pranon kushtet e dhënies së ndihmës. Është e rëndësishme që të merret edhe pëlqimi i fëmijëve dhe të arrihet që ata të kuptojnë se cilat janë procedurat dhe ndihma që ofrohet. Në rast se fëmija është pa kujdes prindëror, leja përfundimtare mund të jepet vetëm nga kujdestari ligjor i fëmijës.

### **KUSH**

QPS, konkretisht Menaxheri I Rastit.

### **SI**

QPS duhet të hartojë një formular pranimi ku jepen hollësitë, të paktën mbi: Listën e shërbimeve që ofrohen; Rregullat që duhet të pranohen; Kushtet sipas të cilave ofrohen shërbimet.

Përfituesit të shërbimeve (fëmija dhe familja) duhet t'i bëhet një përshkrim i qartë i shërbimeve që ofrohen. Përfituesit duhet t'i jepet kohë e mjaftueshme për të lexuar formularin e pranimit, ose për t'ia lexuar asaj/atij dhe për t'ia marrë parasysh mundesitë që mund të ketë vete përfituesi.

Pëlqimi për pranimin e shërbimeve dhe të kushteve të shërbimit kufizohet vetëm për ato shërbime, që përshkruhen me shkrim në marrëveshjen formale. Ky formular pranimi duhet të firmoset nga ata, që do të përfitojë nga shërbimet, apo në rastin e fëmijëve, ose nga fëmija dhe kujdestari i tyre.



## Masa 5: MBROJTJA DHE REHABILITIMI I FËMIJËVE

### Mbrojtja e Fëmijës

Në rastet kur fëmija është i/e pashoqëruar ose në nivel të lartë rreziku atëherë QPS duhet të merr vendim për marrjen e fëmijës në mbrojtje të menjëhershme. Kur fëmija merret në mbrojtje atëherë ai/ajo shoqërohet në kujdes alternativaty ku ekzistojnë shërbime mbrojtëse. Fëmija shoqërohet në strehim alternativ në bazë të formularit të dorëzimit të fëmijës deri në 72 orë nga mbërritja e fëmijës në qëndër.

### KUR

Menjëherë pas vlerësimit fillestar, kur përcaktohet rreziku i menjëhershëm dhe përcaktohet ndërhyrja: shoqërim i fëmijës për marrjen e shërbimeve ose vendosjen e fëmijës në strehim

### KUSH

QPS

### SI

Me bashkërendimin e aktiviteteve mes institucioneve relevante, fëmija vendoset nën mbrojtje brenda 72 orëve pas vlerësimit.

Në rast të vendosjes së fëmijës në strehim, fillon ofrimi i shërbimeve:

- Mbështetje psiko sociale (fëmijës i lihet koha për t'u qetësuar e kupuar situatën e re në të cilën ndodhet)
- Mbështetje mjekësore dhe higjieno sanitare sipas nevojave
- Ushqim dhe veshmbathje
- Marrja e të dhënave administrative edhe kontrollimi i tyre së bashku me Policinë
- Intervista formale me fëmijën pasi fëmija të jetë qetësuar e të jetë gati për të.

Në raste specifike, në mungesë të shërbimeve, vlerësimi dhe ndihma e menjëhershme mund të jepen nga Institucionet e Përkujdesit Rezidencial. Në të gjitha rastet procesi i vlerësimit do të jetë i njëjtë me atë të shpjeguar më sipër.

### Rehabilitimi dhe Reintegrimit i Fëmijës

Procesi i Rehabilitimit dhe Reintegrimit të fëmijës mbështetet nga ofruesit profesionistë të shërbimeve të cilët janë përgjegjës për sigurinë e fëmijës, shqyrtimin dhe trajtimin e problemeve mjekësore; shqyrtimin dhe trajtimin e nevojave psikologjike; ofrimin e mbështetjes ligjore; shqyrtimin e rrezikut të paragjykim social dhe lehtësimin e përfshirjes sociale; fuqizimin e perfituesit/të stabilitetit të perfituesit; reintegrimit në sistemin arsimor dhe bashkëpunimin mes ofruesve të shërbimeve drejtimit të planifikimit dhe përgatitjes së hapave të mëtejshëm që do të ndërmarrë fëmija.

### KUR

Ndihma për rehabilitimin dhe ri-integrimit do të jepet pas stabilizimit të fëmijës, dhe potencialisht pas kthimit të tij/saj në familje

### KUSH

Procesi i udhëhequr nga Menaxheri Rastit, me pjesëmarrjen e të gjitha akterëve në planin individual të shërbimeve për fëmijën.

Shërbimet ofrohen nga një sërë ofruesish qeveritarë dhe joqeveritarë përfshirë mjekët, psikologët, edukatorët/mësuesit, juristët, punonjësit social, etj. Përgjegjësitë e secilës pale detajohen në Planin Individual.

### SI

Masat për përkujdesjen, ndihmën, rehabilitimin dhe ri-integrimit të fëmijëve, janë përgjegjësi e ofruesve të shërbimeve në varësi të zgjidhjes afat-gjatë që është vlerësuar për fëmijën. Këto masa janë të detajuara në planin individual të shërbimeve, ku janë të përcaktuara edhe përgjegjësitë e institucioneve edhe afatet kohore për ofrimin e shërbimeve. Përkrahja vazhdon derisa ekipi të vlerësojë se fëmija nuk ka nevojë më për këto shërbime.

**Kujdesi i rehabilitimit përfshin:**

- trajtimin e vazhdueshëm të nevojave shëndetësore;
- përkrahjen psiko/sociale
- rritjen e ndjenjës së pavarësisë dhe të vendim-marrjes së perfituesin (fuqizimi i perfituesit);
- perfitimin e njohurime dhe i aftësive profesionale
- përgatitja për integrimin ose për ri-integrimin shoqëror;
- shqyrtimin e vazhdueshëm të gjendjes së sigurisë;
- shqyrtimin psikologjik/raportin e progresit;
- mbështetjen ligjore;
- mbështetjen financiare;
- mundësitë e arsimimit/të trenimit profesional, përfshirë dhe fitimin e aftësive për jetën; dhe
- diagnostikimin ose kurimin shëndetësor për probleme të patrajuara deri atëherë.

Gjatë të gjitha fazave të procesit, organet përkatëse, nën mbikqyrjen e Menaxherit të rastit të fëmijës, duhet të bëjnë kujdes që shërbimet e ofruara, si edhe format e tjera të ndihmës t'u përgjigjen standardeve minimale që kërkohen për mirëqenien e një fëmijë.

Procesi i rehabilitimit dhe reintegrimit fokusohet fillimisht në trajtimin e nevojave të identifikuara nga vlerësimi. Procesi në vete, në aspekt administrativ, përfshin edhe:

- Ri-shqyrtimin/ri-vlerësimin e përparimit të bërë nga fëmija në fusha të ndryshme;
- Takimin/diskutimin e ekipit, i bashkërenduar me anëtarët e ekipit mbështetës;
- Shqyrtimin e rrezikut për perfituesin;
- Komunikimet dhe bashkërendimet me institucionet tjera

- Hartimin e planeve për hapat e mëtejshëm në fushat kyçe.

Masat e ndihmës për ri-integrim përfshijnë shërbimet e mbështetjes dhe programet e edukim dhe trajnimit që ofrohen për fëmijën. Mbështetja për ri-integrim mund të përfshijë:

- Këshillimin psikologjik;
- Këshillimin ligjor;
- Këshillimi I familjarëve
- Ndihmën e vazhdueshme mjeksore
- Arsimitin dhe/ose trajnimin profesional;
- Referimi në kursë të ndryshme varësisht nga nevojat dhe interes të fëmijës
- Referimi I anëtarëve të familjes në zyret e punësimit
- Fuqizimin ekonomik të familjes;
- Ofrimi I ndihmës sociale
- Masat e ri-integrimit në familje/komunitet;
- Monitorimin dhe vlerësimin e rastit

Në masat e ndihmës rehabilituese dhe reintegruese, institucionet mund të ofrojnë shërbime conform fushëveprimit të tyre.

**Institucionet Arsimore**

- Ofrojnë mbështetjen e individualizuar edukative për tërheqjen e fëmijëve nga puna;
- Ofrojnë mbështetjen e reintegrimit social dhe arsimor të fëmijëve
- Sensibilizojnë nxënësit për problemin
- Inkurajojnë Grupet për të Drejtat e Fëmijëve për organizimin e fushatave vetdijësuese në shkollë dhe për organizimin e aktiviteteve të ndryshme për përkrahje shoku-shokun;
- Bashkëpunojnë me ofruesit tjerë të shërbimeve dhe partnerët (policinë, QPS-të,

OJQ-të që ofrojnë programe edukative dhe që kanë në fokus mbrojtjen e fëmijëve, bizneset, etj) me qëllim largimin nga puna të fëmijëve që kombinojnë shkollën dhe punën apo/dhe kthimin e reintegrimit të fëmijëve të cilët e kanë braktisur shkollën;

### **Institucionet Shëndetësore**

- Bashkëpunojnë me institucionet shkollore dhe QPS-të në ofrimin e mbështetjes profesionale në trajtimin e temës së abuzimit ekonomik të fëmijëve dhe pasojat për shëndetin.
- Këshillojnë prindërit ose kujdestarët dhe anëtarët tjerë të familjes së fëmijëve të lënduar në punë për rreziqet e aktiviteteve të caktuara punuese dhe efektet e mundshme të këtyre rreziqeve në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve.

### **OJQ-të mund të ofrojnë përkrahje të shtuar, përmes ofrimit të shërbimeve si:**

- qendra të kujdesit ditor që do të mund të ofronin programe të mbështetjes emocionale, rehabilitimit social si dhe programe mbështetëse arsimore,
- programe edukimi në mesin e bashkëmohatarëve nëpër shkolla për të parandaluar braktisjen e shkollës dhe për të përmirësuar frekuentimin dhe notat e fëmijëve që vijojnë shkollën,
- organizimi i mësimit plotësues për fëmijët me performancën të ulët në lëndë të caktuara, si masë për parandalim apo për largimin e fëmijëve nga puna;
- aktivitete joformale arsimore;
- shërbime të këshillimit për fëmijë, adoleshentë dhe prindër

Varësisht nga situata individuale e fëmijës dhe familjes, dhe rrjedhimisht varësisht nga Plani i Individualizuar i Shërbimeve, angazhohen me detyra përkatëse të rehabilitimit dhe reintegrimit edhe ofrues tjerë të shërbimeve si psh qendrat e shëndetit mendor, zyrat e punësimin, etj.

## Masa 6: ZBATIMI, SHQYRTIMI DHE MONITORIMI I RASTIT

Intervenimi për tërheqjen e një fëmije nga puna e fëmijëve në kuptimin e saj të ngushtë nënkupton zbatimin e planit të shërbimeve dhe vlerësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të realizuara nga të gjithë partnerët, përfshirë ndikimin e tyre në adresimin e nevojave të fëmijës.

Roli kryesor i MR në këtë fazë është:

- Ofrimi i shërbimeve të drejtpërdrejta;
- Monitorimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara përmes referimit;
- Motivimi i fëmijës për të punuar drejt zgjidhjeve të mundshme të përcaktuara në planin e shërbimeve.
- Përcjellja e rastit

Të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime të ndryshme dhe janë në një formë ose tjetër të përfshirë në rast, janë të obliguar të bashkëpunojnë me QPS-në dhe në zbatimin e planit dhe përcjelljen e rastit.

### Zbatimi i Planit

Zbatimi i planit të shërbimeve është procesi i ekzekutimit të masave/aktiviteteve që do të çojnë në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në planin e shërbimeve. Kjo është situata ku MR ofron shërbime të drejtpërdrejta që janë brenda mandatit të QPS-së, monitoron dhe koordinon shërbimet dhe burimet e nevojshme për të arritur rezultatin e dëshiruar në mënyrë që të lehtësohet qasja në shërbime për fëmijën. Në çdo kohë gjatë zbatimit të planit të shërbimeve, MR mund të gjejë veten në rolin e zbatuesit, udhëzuesit apo mbështetësit për zgjidhjen e problemeve.

Menaxheri i rastit (QPS) duhet t'i përcjellë shërbimet të cilat i ka marrë dhe të cilat i ofrohen fëmijës për të qenë në dijeni me gjendjen e fëmijës. Për këtë qëllim, ai/ajo duhet të zhvillojë komunikime periodike me ofruesit e shërbimeve, me fëmijën dhe familjen e tij/saj.

### Monitorimi i planit

Shqyrtimi dhe monitorimi i rastit është një proces i vazhdueshëm që synon të sigurojë që shërbimet cilësore ofrohen me kohë, duke i mundësuar fëmijës të vazhdojë përpara me planin. Ai përqendrohet në atë nëse plani po zbatohet dhe shërbimet po ofrohen, si dhe identifikon çështjet që lidhen me bashkëpunimin e fëmijës/familjes, koordinimin e menaxhimit të rastit dhe sistemin e ofrimit të shërbimeve. Për t'i monitoruar rrethanat e fëmijës ose ndryshimet që ndodhin si rezultat i ndërhyrjeve në menaxhimin e rastit, përveç monitorimit nga afër të shërbimeve të ofruara, MR duhet të jetë në kontakt të vazhdueshëm me fëmijën dhe familjen e fëmijës. Brenda 7 ditëve të referimit fillestar do të ketë të paktën një vizitë në shtëpi nga MR, ndërsa në baza të rregullta MR do të kontaktojë familjen të paktën një herë në muaj. Pas procesit të ri-integrit, vizitat monitoruese të fëmijës do të bëhen të paktën një herë në 6 muaj. Në secilin takim pasues të menaxhimit të rastit, situata e fëmijës kontrollohet kundrejt treguesve të përcaktuar në planin e shërbimeve. Nëse ka ngecje në përparimin e fëmijës kundrejt këtyre treguesve, MR shënon shpjegime ose arsyetime të qarta në dosjen e rastit, dhe vazhdon me rivlerësim nëse është e nevojshme, duke bërë rregullimet e nevojshme në aktivitete dhe duke kërkuar zgjidhje për problemet. Nëse nevojitet rishikimi i aktiviteteve ose identifikimi i zgjidhjeve të reja, MR organizon takim me TMR, respektivisht me institucionet/organizatat e përfshira në zbatimin e planit të shërbimeve.

Menaxheri i rastit duhet të verifikojë edhe cilësinë e shërbimeve të cilat i ofrohen fëmijës dhe kontrollimin e informatave të cilat i ofrojnë ofruesit e shërbimeve që të janë të besueshme dhe të sakta.

Monitorimi i cilësisë së shërbimeve që i ofrohen fëmijës mund të bëhet përmes vizitave të drejtpërdrejta vëzhguese, takimeve të drejtpërdrejta me personelin përkatës, telefonit, postës elektronike dhe/ose mjeteve të tjera të komunikimit deri në momentin e mbylljes së rastit.

Monitorimi i cilësisë të shërbimeve të ofruara nga OJQ-të duhet të bëhet në përputhje me standardet mbi shërbimet sociale dhe familjare të vendosura nga Këshilli I Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale dhe Familjare.

Të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga MR si pjesë e zbatimit të planit të shërbimeve, rishikimi dhe monitorimi i rastit duhet të regjistrohen në formularin përkatës

### Vlerësimi i planit

Vlerësimi i planit të shërbimeve bëhet nga Ekipi multidisciplinarë ose Tryeza për Menaxhimin e Rastit, për t'i rishikuar ndërhyrjet dhe për të marrë vendime zyrtare në interesin më të mirë të fëmijës. MR gjithashtu duhet ta mbajë fëmijën dhe familjen e tij të përfshirë në monitorimin e progresit dhe marrjen e vendimeve gjatë zbatimit të planit të shërbimeve.

Mbyllja e rastit i referohet pikës në të cilën përfundon menaxhimi i rastit. Mbyllja e rastit duhet të jetë e planifikuar mirë brenda planit të shërbimeve, ndërsa fëmija dhe familja e tij duhet të dine paraprakisht që në një kohë të përshtatshme shërbimet do të përfundojnë. Fokusi i këtij hapi nuk është thjesht në mbylljen e rastit, por procesi duhet të siguroj që fëmija është në gjendje t'i mirëmbajë arritjet e bëra dhe gjasat e rishfaqjes së problemit janë zvogëluar. Prandaj, rasti nuk «mbyllet» kur përfundon intervenimi, por vetëm pas një periudhe monitorimi, e cila është e mjaftueshme për të parë nëse ndryshimet e arritura janë të qëndrueshme dhe afatgjata. Në të njëjtën kohë, MR duhet të shmangë cytjen e varësisë së fëmijës dhe familjes së tij nga shërbimet sociale.

### Dokumentimi

QPS duhet në vazhdimësi të bëjë evidentimin e të dhënave në bazën e të dhënave dhe raportimin mbi zbatimin e planit të shërbimeve.

Për këtë, të gjithë partnerët e përfshirë duhet të mbajnë shënime për veprimet e ndryshme në të zbatuara nga ata (p.sh. shkollat, qendrat

shëndetësore, inspektorët e punës, policia, ofruesit e shërbimeve do të mbajnë shënime për shërbimet e ofruara, etj.)

QPS do t'i konsolidojnë këto të dhëna duke përfshirë a/ numrin e përgjithshëm të fëmijëve të referuar në QPS gjatë periudhës raportuese, b/ përmbledhjen e nevojave të fëmijëve të përfshirë në FRPF, c/ shërbimet e ofruara, d/ mungesën e shërbimeve dhe/apo pengesat për qasje në shërbime, bazuar në raste specifike. Kjo analizë e të dhënave do t'i përcillet DKSHMS në baza gjashtëmujore.

---

► Të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime të ndryshme dhe janë në një formë osë tjetër të përfshirë në rast, janë të obliguar të bashkëpunojnë me QPS-në dhe në zbatimin e planit dhe përcjelljen e rastit.

## Masa 7: MBYLLJA E RASTIT

Mbyllja e rastit i referohet pikës në të cilën përfundon menaxhimi i rastit. Mbyllja e rastit duhet të jetë e planifikuar mirë brenda planit të shërbimeve, ndërsa fëmija dhe familja e tij duhet të dinë paraprakisht që në një kohë të përshtatshme shërbimet do të përfundojnë. Fokusi i këtij hapi nuk është thjesht në mbylljen e rastit, por procesi duhet të siguroj që fëmija është në gjendje t'i mirëmbajë arritjet e bëra dhe gjasat e rishfaqjes së problemit janë zvogëluar. Prandaj, rasti nuk «mbyllet» kur përfundon intervenimi, por vetëm pas një periudhe monitorimi, e cila është e mjaftueshme për të parë nëse ndryshimet e arritura janë të qëndrueshme dhe afatgjata. Në të njëjtën kohë, MR duhet të shmangë cytjen e varësisë së fëmijës dhe familjes së tij nga shërbimet sociale.

Mbyllja e rastit mund të jetë rezultat i disa arsyeve:

- Qëllimi është arritur, që do të thotë që çështja e mbrojtjes së fëmijës është zgjidhur sipas planit të shërbimeve; -
- Fëmija arrin statusin e të rriturit;
- Fëmija vdes;
- Fëmija transferohet jashtë Kosovës
- Ku fëmija transferohet në një organizatë/ institucion tjetër. Transferimi i një rasti tregon që përgjegjësia e plotë për koordinimin e planit të shërbimeve, aktivitetet pasuese dhe monitorimin e fëmijës i dorëzohet një departamenti tjetër. Kjo dallon nga referimi i rasteve, ku këto përgjegjësi mbesin me MR fillestar.

Kur mbyllet një rast, është e rëndësishme të informohet fëmija dhe/ose familjen e tij/saj për arsyet e mbylljes së rastit dhe të ndihmohen ata të rishikojnë dhe vlerësojnë progresin dhe qëllimet e arritura dhe të qasen në opsione dhe zgjidhje të tjera. Mbyllja e rastit evidentohet në Formën E7: Mbyllja e Rastit (shih shtojcën).

### Përcjellja e rastit

Menaxheri i rastit (QPS) duhet t'i përcjellë shërbimet të cilat i ka marrë dhe të cilat i ofrohen fëmijës ish punëtorë për të qenë në dijeni me vendndodhjen e fëmijës.

Përcjellja poashtu kërkon që:

1. Policia të përcjell fëmijët e tërhequr nga puna në rrugë,
2. Inspektorët të mbajnë shënime për fëmijët e tërhequr nga sektori formal
3. Partnerët tjerë të cilët janë në gjendje të përcjellin rastet e caktuara të fëmijëve të tërhequr nga puna dhe t'a njoftojnë menaxherin e rastit në baza të rregullta.

Menaxheri i Rastit duhet të zhvillojë komunikime periodike me ofruesit e shërbimeve, me fëmijën dhe familjen e tij/saj.

## ► MONITORIMI DHE VLERËSIMI

PSV-të shërbejnë dhe veprojnë në nivel lokal, dhe përfshijnë monitorimin e vendeve të punës, shkollave/shërbimeve dhe komunitetit. Procesi synon të sigurojë se vajzat dhe djemtë nuk janë të përfshirë në format e rrezikshme të punës dhe janë në shkolla. Këto PSV:

- Janë të aplikueshme për të gjitha kategoritë e FRRPF të përcaktuara nga Ministria përkatëse në listën e FRRPF
- Veprojnë në nivel lokal, mbulojnë vendpunishtet/shkollat/familjet dhe përfshijnë
- sistemin e referimit në shërbime
- Mbështeten në autoritetin e qeverisë lokale dhe qendrore
- Ndërlidhen me politikat dhe veprimet kombëtare mbi MF
- Ngriten mbi sistemet ekzistuese të menaxhimit të informacionit

Menagjimi i PSV-ve në nivel lokal është i vendosur në Drejtoritë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DKSHMS). DKSHMS do të koordinojnë procesin në nivel lokal. Në nivel qendror, MPF do të menagjohet nga Departamenti për Politika Sociale dhe Familje.

Monitorimi dhe vlerësimi i implementimit të PSV-ve është proces i rëndësishëm që duhet të bëhen në formë sistematike. Përmes këtij procesi synohet të vlerësohet aplikueshmëria e PSV-ve në praktikë, synohet të vlerësohet niveli i implementimit nga akterët e ndryshëm si dhe të identifikohen vështirësitë dhe sfidat e mundshme në implementimin e tyre. Monitorimi i implementimit të PSV-ve shërben për disa qëllime:

- Mban përgjegjës secilin nga institucionet sa i përket përbushjes së obligimeve ligjore.
- Mundëson identifikimin e zbrastësive në PSV, legjisllacion dhe praktikat aktuale.

► Informatat e mbledhura përmes monitorimit dhe vlerësimit ndihmojnë përmirësimin e PSV-ve, strategjive për monitorimin e punës së fëmijëve dhe në formulimin e legjisllacionit në të ardhmen.

► Ndihmon në vlerësimin e nevojës për vetëdijësim për parandalimin, raportimin dhe luftimin e punës së fëmijëve dhe ofrimin e shërbimeve të integruara.

Monitorimi dhe vlerësimi i përditshëm i implementimit të PSV-ve duhet të bëhet përbrenda secilit institucion. Secili institucion që është përgjegjës për implementimin e PSV-ve është i obliguar edhe ta monitoroj dhe vlerësoj implementimin e tyre – sipas zinxhirit hierarkik (p.sh Policia e monitoron strukturat e veta në zbatimin e PSV-ve përbrenda departamenteve dhe njësive të saj, dhe gjatë raportimit të rregullt të njësive të ndryshme vlerësohet edhe implementimi i PSV-ve).

Mekanzimat institucional operacional të listuar më lartë duhet të raportojnë rregullisht tek mekanizmat institucional monitorues.

Të gjitha të dhënat e evidentuara mbi rastet e identifikuar të fëmijëve në punë dhe shërbimet e ofruara për ta duhet të konsolidohen dhe si të tilla të shfrytëzohen për veprim dhe për planifikime sociale dhe të politikave lokale dhe shtetërore.

QPS do t'i konsolidojnë këto të dhëna duke përfshirë a/ numrin e përgjithshëm të fëmijëve të referuar në QPS gjatë periudhës raportuese, b/ përmbledhjen e nevojave të fëmijëve të përfshirë në FRPF, c/ shërbimet e ofruara, d/ mungesën e shërbimeve dhe/apo pengesat për qasje në shërbime, bazuar në raste specifike. Kjo analizë e të dhënave do t'i përcillet EDF-se dhe DKSHMS në baza gjashtëmujore.

Me qëllim të monitorimit, të ofrimit të të dhënave për fuqizim dhe përmirësim të ligjeve dhe politikave, dhe për planifikim sociale, EDF do të thërras takimet të rregullta për të a/ shqyrtuar të dhënat e konsoliduara, b/ procesin e identifikimit të fëmijëve në punë dhe

vendpunishteve, c/ progresin në zbatimin e planit komunal të veprimit për mbrojtjen e fëmijëve nga puna dhe c/ mundësitë dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave që kanë të bëjnë me eliminimin e PF.

Informatat për shkeljen e ligjeve lidhur me punën e fëmijëve duhet ti vihen në dispozicion nëpunësve zbatues të ligjit dhe të sistemit ligjor.

Në baza vjetore EDF-të përgatisin raportin komunal mbi situatën e punës së fëmijëve përfshirë:

- a. numrin e fëmijëve në punë, përfshirë ndarjen sipas sektorëve dhe rajoneve gjeografike
- b. profilin e fëmijëve, përfshirë nevojat e fëmijëve në punë dhe familjeve të tyre
- c. shërbimet ekzistuese të ofruara për tërheqjen dhe mbrojtjen e fëmijëve nga puna,
- d. mungesën e shërbimeve apo pengesat në qasje,

Në bazë të analizës së situatës EDF përgatit planin komunal të veprimit kundër punës së fëmijëve

DPSF konsolidon të dhënat nga të gjitha komunat dhe i prezanton raportin vjetor Komitetit për Parandalimin dhe Eliminimin e PF, donatorëve dhe partnerëve tjerë të rëndësishëm.

DPSF do të thërras takime me akterët relevant në baza vjetore për të konsoliduar të dhënat e pranuar nga terreni:

- a. mbi trendet e punës së fëmijëve në sektorët dhe/apo rajonet specifike,
- b. shërbimet ekzistuese të ofruara për ta,
- c. mungesën e shërbimeve apo pengesat në qasje dhe
- d. rekomandimet për veprime të mëtutjeshme

DPSF është duke punuar për të zgjeruar modulën e menaxhimit të rastit për fëmijët në forma të rrezikshme të punës në bazën e të dhënave të shërbimeve sociale për të mundësuar një menaxhim të rastit të integruar

dhe shumë-palësh sipas roleve specifike të secilit institucion të përfshirë në ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve në forma të rrezikshme të punës. Poashtu, njëherë në vit, bëhet vlerësimi i zbatimit të PSV-ve në nivel vendi. Është më se e rëndësishme që të bëhet edhe një monitorim dhe vlerësim i jashtëm/i paanshëm mbi implementimin e PSV-ve (që mund të kontraktohet nga DPSF), në mënyrë që të sigurohet një pasqyrë reale mbi implementimin e tyre. Ky monitorim dhe vlerësim i jashtëm mund të bëhet nga ndonjë institucion /OJQ lokale (në mënyrë vullnetare apo edhe përmes angazhimit të tyre vetëm për qëllim të monitorimit dhe vlerësimit) apo nga ndonjë institucion ndërkombëtar.

Raporti i rregullt kombëtar i nxjerrë nga këto vlerësime duhet t'i prezentohet të gjitha palëve të interesit, institucioneve, donatorëve e partnerëve në baza vjetore.

### Dokumentimi

Menaxhimi i informacionit bëhet përmes një dosje të përbërë nga formate të paracaktuara, kritere të para-dakorduara për zbulimin e informacionit për personat e autorizuar. Menaxheri i rastit është përgjegjës për koordinimin e informacionit, konsolidimin e tij dhe analizën vijuese.

Një sistem gjithëpërfshirës për mbledhjen, ruajtjen dhe shkëmbimin e informacionit për menaxhimin e rasteve është i rëndësishëm në përmirësimin e efektivitetit të përgjithshëm të shërbimeve të menaxhimit të rasteve. Proceset e zakonshme të menaxhimit të informacionit në

QPS është përgjegjëse dokumentacionin, mbajtjen e regjistrave, menaxhimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe ndarjen e analizës së informacionit me akterët e jashtëm.


Të gjithë partnerët e përfshirë në PSV duhet të mbajnë shënime për veprimet e ndryshme në PSV të zbatuara nga ata (p.sh. shkollat, qendrat shëndetësore, inspektorët, policia në bashkësi do të mbajnë shënime mbi fëmijët e referuar nga vet ata në QPS, ofruesit e shërbimeve do të mbajnë shënime për shërbimet e ofruara, etj.) Menaxherët e rasteve në QPS do të mirëmbajnë të dhënat e konsoliduara për secilin rast në dosjet personale (në konsultim me partnerët e ndërlidhur).



Dokumentacioni duhet të jetë zinxhir i pandërprerë i informacionit, andaj Menaxherët e Rasteve duhet t'i regjistrojnë të gjitha fazat e ndërhyrjes dhe të përshkruajnë në mënyrë kronologjike informacionin, aktivitetet dhe përdorimin e shërbimeve, si dhe veprimet, reagimet

dhe arritjet e fëmijës. Dokumentacioni i duhur mundëson shërbime efektive dhe të përgjegjshme për menaxhimin e rasteve. Informacioni i grumbulluar direkt dhe indirekt nga fëmijët dhe familjet e tyre, si dhe nga ofruesit e shërbimeve duhet të ruhet nga QPS.

- 
- ■ Të gjitha të dhënat e evidentuara mbi rastet e identifikuara të fëmijëve në punë dhe shërbimet e ofruara për ta duhet të konsolidohen dhe si të tilla të shfrytëzohen për veprim dhe për planifikime sociale dhe të politikave lokale dhe shtetërore.



# SHTOJCAT:

---



Forma E1: Referimi i rastit

Forma E2: Caktimi i Menaxherit të Rastit

Forma E3: Vlerësimi i Rastit

Forma E4: Plani i Shërbimeve

Forma E7: Mbyllja e Rastit



## ► REFERIMI I RASTIT

### 1. REFERUESI/JA

(Të dhënat e palës që ka referuar rastin, në rast se ofrohen)

### 2. FORMA E REFERIMIT

direkte

përmes telefonit

tjetër \_\_\_\_\_

### 3. TË DHËNAT E RASTIT

(Të dhënat të cilat i posedon referuesi/ja)

### 4. ARSYET PËR REFERIM

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

### 5. DOKUMENTET E OFRU

(në rast se i posedon referuesi/ja)

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

### 6. REFERIMI PRANUAR NGA


**Vërejtje:** Në rast të referimit nga ndonjë institucion/organizatë, një kopje e referimit i jipet palës e cila ka referuar rastin

## ► CAKTIMI I MENAXHERIT TË RASTIT

### 1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË RASTIT

Kategoria	Puna e rrezikshme e fëmijëve	Kodi i shërbimit:	XXXXXXX
-----------	------------------------------	-------------------	---------

### 2. FORMA E REFERIMIT

Zyra	{plotesohet pasi futet ne sistem}	Menaxheri rastit	{plotesohet pasi futet ne sistem}
Nr. Rastit	{plotesohet pasi futet ne sistem}	Emri fëmijës	{plotesohet pasi futet ne sistem}
Data hapjes së rastit	{plotesohet pasi futet ne sistem}	Mbiemri fëmijës	{plotesohet pasi futet ne sistem}
Data regjistrimit në SI	{plotesohet pasi futet ne sistem}	Nr. Identifikues	{plotesohet pasi futet ne sistem}

### 2. FORMA E REFERIMIT TË RASTIT

nga vet fëmija

në emër të fëmijës, nga \_\_\_\_\_

### 3. SHËNIMET E PËRGJITHSHME PËR RASTIN

Lloji idenfitikimit		Nr. Personal fëmiut	
Emri fëmiut		Emri prindit fëmiut	
Mbiemri fëmiut		Gjinia fëmiut	
Datëlindja fëmiut		Vendi lindjes fëmiut	
Nacionaliteti		Gjuha që flet	
Komuna e përkohshme		Vendbanimi i përkohshëm	
Adresa e përkohshme		Komuna e përhershme	
Vendbanimi i përhershëm		Adresa e përhershme	
Riatdhesuar?		Shteti riatdhesimit	
Telefon		Email	

### 4. SQARO ARSYEN E PARAQITJES SË RASTIT

**5. A KA QENË FËMIJA/FAMILJA E TIJ MË PARË PËRFITUES I SHËRBIMEVE TË QPS-SË?** po jo

Nëse po, cfarë periudhe? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Cila ka qenë arsyeja? \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Shërbimet nga të cilat ka përfituar

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**6. CAKTIMI I MENAXHERIT TË RASTIT (TË PLOTËSOHET NGA UDHËHEQËSI I SHËRBIMEVE OSE ZYRTARI I AUTORIZUAR)**

Data e pranimit

Data e takimit me klientin

**6.1. PËRSHKRIMI I SHKURTËR I RASTIT**

Data	Udhëheqësi i Shërbimit (emri mbiemri)	Nënshkrimi
_____	_____	_____
Data	Udhëheqësi i Shërbimit (emri mbiemri)	Nënshkrimi
_____	_____	_____
Data	Udhëheqësi i Shërbimit (emri mbiemri)	Nënshkrimi
_____	_____	_____

\_\_\_\_\_  
 Nënshkrimi i nëpunësit të shërbimeve  
 që ka pranuar rastin

## ► VLERËSIMI I RASTIT

### 1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË RASTIT

Kategoria	Puna e rrezikshme e fëmijëve	Kodi i shërbimit:	XXXXXXX
Zyrja	[F2]	Menaxheri rastit	[F6]
Nr. Rastit	[F3]	Emri fëmijës	[F7]
Data hapjes së rastit	[F4]	Mbiemri fëmijës	[F8]
Data regjistrimit në SI	[F5]	Nr. Identifikues	[F9]

### 2. SEKTORI

- Punë në rrugë (shitje të gjëseneve të imta, bartje/transportim i mallrave me karrocë, kërkim lëmoshe, ...)
- Punë shtëpiake
- Bujqësi
- Pylltari
- Ndërtimtari
- Reciklim (puna në deponi të mbeturinave apo mbledhja e mbeturinave në kontenjerë)
- Exploatim i pasurive natyrore (gërmime sipërfaqësore të rërës, gurëve, thëngjillit)
- Shfrytëzim për aktivitete të ndaluara (shitje dhe/apo prodhim droge, vjedhje, etj.)

Tjetër \_\_\_\_\_

#### 2.1. RREZIQET TË CILAVE U EKSPOZOHEM FËMIJA

- Rreziqet nga mjedisi i punës
- Rreziqet nga aktivitetet punuese
- Rreziqet nga mjetet e punës
- Rreziqet nga kohëzgjatja/orari i punës

#### 2.1. RREZIQET TË CILAVE U EKSPOZOHEM FËMIJA

Lokacioni ku punon fëmija

Orari ditor i punës

Sa orë pune në javë

#### 2.3. AKSIDENTET/LËNDIMET/PROBLEMET SHËNDETËSORE APO PROBLEMET TJERA ME TË CILAT ËSHTË PËR-BALLË FËMIJA SI PASOJË E ANGAZHIMIT TË TIJ/SAJ NË PUNË

#### 2.4. SHKALLA E RREZIKSHMËRISË

- e lartë (nevojitet intervenim i menjëhershëm për mbrojtjen e fëmijës nga dëmtimi...vlerësimi i mëtejshëm i rastit vazhdon më pas)
- mesatare (nevojitet vlerësim i mëtejshëm i rastit dhe mbështetje)
- e ulët (referim në shërbime të tjera dhe mbikqyrje për adresim adekuat të situatës)

#### 2.5. MËNYRA E ANGAZHIMIT TË FËMIJËS NË PUNË

- e vazhdueshme, nga muaji/viti: \_\_\_\_\_
- e kohëpaskohshme apo sezonale (kur-periudha vjetore e angazhimit): \_\_\_\_\_

Të ardhurat mujore të fëmijës: \_\_\_\_\_

Mosha kur fëmija ka filluar punëmija ka filluar punës: \_\_\_\_\_

#### 2.6. ARSYET PËR PUNË

#### 2.7. PERCEPTIMET E FËMIJËS RRETH PUNËS DHE ARSYJEVE TË ANGAZHIMIT NË PUNË

### 3. PROFILI I FAMILJES

- Të dy prindërit
- Me njërin prind
- Me kujdestar
- Pa përkujdesje prindërore

Tjetër \_\_\_\_\_

#### 3.1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PRINDËRIT/KUJDESTARËT (GJENDJA PSIKO-FIZIKE, PUNËSIMI, INTERESIMI PËR PUNË, KAPACITETI PËR PUNË, AFTËSITË E PRINDËRIMIT)

--	--	--	--

#### 3.2. VËLLEZËRIT DHE MOTRAT

Numri		Mosha	
-------	--	-------	--

#### 3.2.1. SHQETËSIMET EVENTUALE NË LIDHJE ME VËLLEZËRIT DHE MOTRAT (NGA ASPEKTI I SIGURISË, USHQYESHMËRISË, VIJUESHMËRISË SË SHKOLLËS, PËRFSHIRJES NË PUNË APO TJETËR)

---

---



**3.3. ANËTARËT TJERË TË FAMILJES**

*(Kush jeton me fëmijën, përveç familjes së ngushtë)*

**3.3.1. GJENDJA PSIKO-FIZIKE, KONTRIBUTI NË FAMILJE, PËRKRAHJA QË JU NEVOJITET APO INFORMATË TJETËR ME RËNDËSI:****4. KUSHTET ELEMENTARE TË JETESËS****4.1. KUSHTET E BANIMIT**

shtëpi \_\_\_\_ m<sup>2</sup>

banesë \_\_\_\_ m<sup>2</sup>

Tjetër \_\_\_\_\_

**4.2. PËRSHKRIM I CILËSISË SË KUSHTEVE TË BANIMIT (KUFIZOHUNI NË KONSTATIM TË FAKTEVE NË LIDHJE ME PASTËRTINË, HAPËSIRAT E BANIMIT, QASJEN NË UJË TË PIJSHËM..., PA VLERËSIME SUBJEKTIVE)****4.3. USHQYESHMËRIA (SA RACIONE TË USHQIMIT MERR FËMIJA NË BAZË DITORE, CILËSIA E USHQIMIT QË KONSUMON)****4.4. BURIMET E TË HYRAVE NË FAMILJE****5. GJENDJA SHËNDETËSORE****5.1. SHËNDETI FIZIK (PESHA, GJATËSIA, PROBLEMET SHËNDETËSORE, TRAJTIMI SHËNDETËSOR):****5.2. SHËNDETI DHE MIRËQENIA MENDORE DHE EMOCIONALE (TËRHEQJA, FRIKA, ANKSIOZITETI, SHQETËSIMI, NDRYSHIMET E PAPRITURA NË SJELLJE, VËSHITRËSI NË MENAXHIMIN E ZEMËRIMIT, ...):**

**6. RAPORTET FAMILJARE DHE SHOQËRORE**

(1- asnjëherë/fare; 2- pothuajse fare 3 - nganjëherë; 4 - pothuajse gjithmonë; 5 - gjithmonë)

<b>SIGURIA DHE RELACIONET NË FAMILJE</b>	<b>KOMENT/SQARIM (MUNDËSISHT DEKLARATAT DIREKTE TË FËMIJËS)</b>
Fëmija ndihet i sigurtë në shtëpi	1   2   3   4   5
Fëmija ndjehet i lirë t'i shprehët prindërve (për gjerat që e preokupojnë apo i interesojnë)	1   2   3   4   5
Fëmija gjen mbështetjen e prindërve kur i nevojitet	1   2   3   4   5
<b>RELACIONET SHOQËRORE</b>	<b>KOMENT/SQARIM (MUNDËSISHT DEKLARATAT DIREKTE TË FËMIJËS)</b>
Fëmija ka së paku një shok/shoqe të ngushtë:	1   2   3   4   5
Fëmija ndjehet mirë kur është me shokë/shoqe:	1   2   3   4   5
Sa kohë ka kaluar javën e fundit me shokë/shoqe, jashtë shkollës:	
për të biseduar	1   2   3   4   5
për tu argëtuar	1   2   3   4   5
<b>RELACIONET ME FAMILJEN E GJERË</b>	<b>KOMENT/ SQARIM/ SHEMBULL TË NJË SITUATE REALE (MUNDËSISHT DEKLARATAT DIREKTE TË FËMIJËS)</b>
Fëmija ka kontakt të vazhdueshëm me anëtarë të familjes së gjerë	1   2   3   4   5
Fëmija mund t'i drejtohet ndonjë anëtari të familjes së gjerë kur ka ndonjë shqetësim apo preokupim:	1   2   3   4   5
Fëmija gjen mbështetjen e familjes së gjerë kur i nevojitet:	1   2   3   4   5

**7. ARSIMIMI I FËMIJËS, SHFRYTËZIMI I KOHËS SË LIRË DHE INTERESIMET** Nuk është rexhistruar në shkollë Arsyeja: \_\_\_\_\_ Ka braktisur shkollën Arsyeja: \_\_\_\_\_

Klasa e fundit e përfunduar: \_\_\_\_\_

Viti i fundit (kalendari) i fëmijës në shkollë: \_\_\_\_\_

Shkolla e fundit të cilën e ka vizuar fëmija: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

- Kombinon shkollën dhe punën (punë ekonomike apo jo-ekonomike, përfshirë aktivitetet e mirëmbajtjes së shtëpisë)

Emri i shkollës të cilën e vijon fëmija: \_\_\_\_\_

Klasa aktuale të cilën e vijon fëmija: \_\_\_\_\_

Performanca e fëmijës në shkollë: \_\_\_\_\_

Lëndët e preferuara: \_\_\_\_\_

**Ndikimi i punës në shkollim** \_\_\_\_\_

**Format tjera/alternative të shkollimit/edukimit:**

- Vijon një program të arsimit joformal (nëse PO, cilin dhe ku) \_\_\_\_\_

- Vijon program të aftësisimit profesional/teknik (nëse PO, cilin dhe ku) \_\_\_\_\_

**Aktivitetet me të cilat fëmija merret gjatë kohës së lirë:**

Sa kohe i kushton fëmija këtij aktiviteti: \_\_\_\_\_

Aktivitetet e preferuara të fëmijës dhe interesimet: \_\_\_\_\_

**8. QASJA NË SHËRBIME DHE QËNDRIMI I KOMUNITETIT NDAJ ARSIMIT DHE PUNËS SË FËMIJËVE**

- Shërbime shëndetësore
- Shërbime të planifikimit familjar
- Shërbime të këshillimit familjar
- Qasja në shkollë
- Qasja në institucione parashkollore
- Programe rekreative/sportive
- Programe të rehabilitimit psiko-social
- Programe të aftësisimit profesional
- Shërbime të përkrahjes sociale
- Shërbime të përkrahjes ekonomike
- Mundësi të përkrahjes materiale

Qëndrimi i komunitetit ndaj rëndësisë së arsimit  pozitiv  negativ

Qëndrimi i komunitetit ndaj punës së fëmijëve  pozitiv  negativ

Tjetër \_\_\_\_\_

**8.1. PËRSHKRIM I SHKURTËR I MJEDISIT NË TË CILIN JETON FËMIJA DHE SHËRBIMEVE EKZISTUESE, NGA PERSPEKTIVA E NDIKIMIT TË KËTIJ MJEDISI NË ANGAZHIMIN E FËMIJËS NË PUNË, RESPEKTIVISHT MUNDËSIVE PËR TËRHEQJEN E TIJ/SAJ NGA PUNA (P.SH. DISTANCA DHE QASJA NË SHËRBIMET E CAKTUARA QË DO TË MUND TË KONTRIBUONIN NË TËRHEQJEN E FËMIJËS NGA PUNA, MUNGESA E KËTYRE SHËRBIMEVE, APO TJETËR):**

## 9. PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË RASTIT

ASPEKTET E SIGURISË DHE SHËNDETIT

KUSHTET ELEMENTARE TË JETESËS/PËRMBUSHJA E NEVOJAVE ELEMENTARE

PROFILI I FAMILJES

RAPORTET FAMILJARE DHE SHOQËRORE

ARSIMIMI I FËMIJËS, SHFRYTËZIMI I KOHËS SË LIRË DHE INTERESIMET

SHËRBIMET EKZISTUESE NË LOKALITETIN KU JETON FËMIJA

## 10. INDIKACIONE PËR PLANIN E SHËRBIMEVE

QËLLIMET	MËNYRA PËR ARRITJEN E TYRE
NGA PERSPEKTIVA E FËMIJËS	E FËMIJËS
NGA PERSPEKTIVA E PRINDËRVE/KUJDESTARËVE	E PRINDËRVE/KUJDESTARËVE
NGA PERSPEKTIVA E UDHËHEQËSIT TË RASTIT	E UDHËHEQËSIT TË RASTIT

## 11. BURIMET E TË DHËNAVE

- Vet fëmija
- Prindërit
- Vëllezërit/motrat
- Anëtarët tjerë të familjes që jetojnë me fëmijën
- Anëtarët tjerë të familjes së gjerë
- Shkolla
- Observimi
- Tjetër \_\_\_\_\_

## 12. PËRMBYLLJE E VLERËSIMIT

Data e fillimit të vlerësimit [F12]

Data e përfundimit të vlerësimit

Data e azhurimit në SI

Data: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i Menaxherit të Rastit

► **PLANI I SHËRBIMEVE****1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË RASTIT**

Kategoria	Puna e rrezikshme e fëmijëve	Kodi i shërbimit:	XXXXXXX
Zyrja	[F2]	Menaxheri rastit	[F6]
Nr. Rastit	[F3]	Emri fëmijës	[F7]
Data hapjes së rastit	[F4]	Mbiemri fëmijës	[F8]
Data regjistrimit në SI	[F5]	Nr. Identifikues	[F9]

**1.1 PRINDI/KUJDESTARI**

Emri	[F10]	Mbiemri	[11]
------	-------	---------	------

**2. PLANI AFATSHKURTËR**

	Veprimet	Institucioni përgjegjës	Personi/at përgjegjës	Afati kohor	Treguesit
<b>OBJEKTIVI 1</b>				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
<b>OBJEKTIVI 2</b>				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	

3. PLANI AFATMESËM					
	Veprimet	Institucioni përgjegjës	Personi/at përgjegjës	Afati kohor	Treguesit
<b>OBJEKTIVI 1</b>				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
<b>OBJEKTIVI 2</b>				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	

4. PLANI AFATGJATË					
	Veprimet	Institucioni përgjegjës	Personi/at përgjegjës	Afati kohor	Treguesit
<b>OBJEKTIVI 1</b>				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
<b>OBJEKTIVI 2</b>				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	
				Prej: _____ Deri: _____	

5. APROVIMI I PLANIT TË SHËRBIMEVE		
Data e fillimit të përpilimit		
Data e përfundimit të përpilimit	_____	
Data aprovimit	_____	
Aprovuar nga		Nënshkrimi i aprovuesit: _____
Data e azhurimit në SI	_____	

Data: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i Menaxherit  
të Rastit

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i prindit/kujdestarit



## ► MBYLLJA E RASTIT

### 1. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË RASTIT

Kategoria	Puna e rrezikshme e fëmijëve	Kodi i shërbimit:	XXXXXXX
Zyrja	[F2]	Menaxheri rastit	[F6]
Nr. Rastit	[F3]	Emri fëmijës	[F7]
Data hapjes së rastit	[F4]	Mbiemri fëmijës	[F8]
Data regjistrimit në SI	[F5]	Nr. Identifikues	[F9]

### 2. FËMIJA DHE/APO PRINDI/KUJDESTARI JANË NJOFTUAR PËR ARSYET E MBYLLJES SË RASTIT

- Qëllimi është arritur
- Ndërrim vendbanimi/rasti i transferuar në
- Arritja e moshës madhore
- Tjetër \_\_\_\_\_

### 3. FËMIJA DHE/APO PRINDI/KUJDESTARI JANË NJOFTUAR PËR ARSYET E MBYLLJES SË RASTIT

- Po
- Jo

### 4. NË CFARË FORME JANË NJOFTUAR

- Takim
- Përmes postës
- Përmes tel.
- Tjetër
- Data: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_

### 5. PERSONAT E PËRFSHIRË/KONSULTUAR NË MARRJEN E VENDIMIT PËR MBYLLJEN E RASTIT

### 6. ARSYETIM NË RAST TË DËSHTIMIT PËR TË SIGURUAR APROVIMIN E PRINDIT/KUJDESTARIT PËR MBYLLJEN E RASTIT

### 7. PËRMBYLLJE

Data e mbylljes së rastit	[F2]		
Aprovuar nga		Nënshkrimi	
Data e azhurimit në SI			

Data: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i Menaxherit të Rastit

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i prindit/kujdestarit





